

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 44.1 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 46.2 të Statutit të Komunës, dhe nenit 9.1 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, si dhe sipas kërkesës së Kryetarit të komunës, Kryesuesja e kuvendit të komunës:

Iu fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, e cila do të mbahet më datë **31 janar 2022 (e hënë)** me fillim në ora **10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë mbajtur më datën 06.12.2021;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë mbajtur më datën 14.01.2022;
3. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2021;
4. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2022;
5. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2022;
6. Shqyrtimi i propozim – buxhetit për vitin 2022;
7. Shqyrtimi i propozim – vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete;
8. Shqyrtimi i propozim – vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
9. Shqyrtimi i propozim – vendimit për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM ‘Uniteti’ Mitrovicë SH.A, njësia në Vushtri;
10. Shqyrtimi i propozim – vendimit për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL ‘Përparimi’ SH.A, në Vushtri;
11. Shqyrtimi i propozim – vendimit për themelimin të Komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në Institucionet Edukativo Arsimore dhe Aftësuese Parauniversitare në Komunën e Vushtrrisë;

12. Shqyrtimi i kërkesës të Kryetarit të komunës për miratimin e nismës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e Komisionit për përgatitje të draftit të Statutit të Komunës për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës;
14. Shqyrtimi i peticionit të ish banorëve të fshatit Skoçan për përfshirje në buxhetin e vitit 2022, asfaltimi i rrugës që lidh fshatin. Skoçan me Vushtrinë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10, Tel.038/200 42402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

PËR/ZA/TO:	znj. Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Ferit Idrizi Kryetari i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për thirrje të mbledhjes së jashtëzakonshme të kuvendit të komunës



Në pajtim me nenin 44.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe nenin 46.2 të Statutit të Komunës, kërkoj që të thirret mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit të komunës e cila dot mbahet me datën 31 janar 2022, me fillim në ora 10:00 në sallën e kuvendit.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:


R e n d D i t e

1. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2021.
2. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2022.
3. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2022.
4. Shqyrtimi i propozim – buxhetit për vitin 2022.
5. Shqyrtimi i propozim – vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete.
6. Shqyrtimi i propozim – vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
7. Shqyrtimi i propozim – vendimit për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM ‘Uniteti’ Mitrovicë SH.A, njësia në Vushtrri.
8. Shqyrtimi i propozim – vendimit për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL ‘Përparimi’ SH.A, në Vushtrri.
9. Shqyrtimi i propozim – vendimit për themelimin të Komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e drejtorit/zëvendësdrejtorit/eshës në Institucionet Edukativo Arsimore dhe Aftësuese Para universitare në Komunën e Vushtrrisë.

10. Kërkesë e Kryetarit të komunës për miratimin e nismës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës.
11. Miratimi i vendimit për formimin e Komisionit për përgatitje të draftit të Statutit të Komunës për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës.
12. Shqyrtimi i petitionit të ish banorëve të fshatit Skoçan për përfshirje në buxhetin e vitit 2022, asfaltimi i rrugës që lidh fsh. Skoçan me Vushtrinë.

Bashkëngjitur me kërkesë keni materialet për pikat e rendit të ditës përveç pikës nr.5. Materiali për këtë pikë do të iu dërgohet në fillim të mbledhjes së kuvendit ndërsa për pikën nr. 11, emrat për anëtar të komisionit do të caktohen në seancë të njëjtë.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PËR/ZA/TO:	Kuvendin e komunës
NGA/OD/FROM:	Melihate Basholli/Latifi <i>Melihate Basholli</i>
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë Sekretarisë së kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 24.1.2021

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 54, paragrafit 5 të Statutit të Komunës dhe nenit 5, paragrafit 1, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **24 janar 2022** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2021.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
2. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2022.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
3. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2022.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
4. Shqyrtimi i kërkesës së Sindikatës së Shërbyesve Civilë – dega në Vushtrri për kompensimin e shujtës për punëtorët e administratës komunale.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që t'i dërgohet Zyrës Ligjore për një opinion ligjor, se a ka bazë ligjore për këtë çështje.*
5. Shqyrtimi i Propozim – buxhetit për vitin 2022.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të përgatitet një sqarim se cilat janë obligimet kontraktuale nga qeveria e kaluar dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
7. Shqyrtimi i petitionit nga ish – banorët e fshatit Skoçan për përfshirjen në buxhetin e vitit 2022 asfaltimin e rrugës që lidh fshatin Skoçan me Vushtrrinë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në Komunën e Vushtrrisë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA INAUGURUESE E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,
MBAJTUR MË 06 DHJETOR 2021

Mbledhja është mbajtur në sallën e Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina pjesa solemne ndërsa pjesa zgjedhore e mbledhjes është mbajtur në sallën e ”Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Adnan Lahu, Agron Përçuku, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakte Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gentiana Rama, Gresa Muli, Hava Mlinaku, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Miradije Maloku, Mirko Masic, Nasuf Aliu, Nuri Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkëlzen Xhaferi, Sylejman Meholli, dhe Ymer Haradinaj.

Mungoi: Xhafer Tahiri, anëtar i kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i zgjedhur i komunës, z.Ferit Idrizi, komandanti i Stacionit Policor në Vushtrri, përfaqësuesi i Akademisë Policore në Vushtrri, përfaqësuesit e MAPL-së, përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile, mysafirë dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Ali Januzi – anëtar i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-në cilësinë e anëtarit më të vjetër të kuvendit, udhëhoqi mbledhjen e kuvendit, ai më pas përshëndeti të pranishmit, dhe iu uroj suksese anëtarëve të zgjedhur të kuvendit.

Pas votimit Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mënyrë “unanime” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Formimi i komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë- verifikimi i mandateve nga komisioni në fjalë;
2. Dhënia e betimit të anëtarëve të kuvendit dhe e kryetarit të komunës (pjesa solemne) dhe
3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë (pjesa zgjedhore).

1. Formimi i komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë- verifikimi i mandateve nga komisioni në fjalë;

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit - propozoi që anëtar i komisionit për verifikimin e mandateve nga radhët e PDK-së të jetë **Ilmi Azemi**.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit - propozoi që anëtar i komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të kuvendit nga radhët e LDK-së të jetë Behar Duraku.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit - propozoi që anëtar i komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të kuvendit nga radhët e LVV-së të jetë Mek Selaci.

Pas votimit, kuvendi në mënyrë unanime miratoi propozimet për themelimin e komisionit për verifikimin e mandateve të kuvendit në këtë përbërje:

Ilmi Azemi nga radhët e PDK-së;
Behar Duraku nga radhët e LDK dhe
Mek Selaci nga radhët e LVV-së.

Komisioni i sipërcekur bëri verifikimin e mandateve të kuvendit, duke lexuar emrat e secilit anëtar të zgjedhur të kuvendit.

2. Dhënia e betimit të anëtarëve të kuvendit dhe e kryetarit të komunës (**pjesa solemne**);

Në vazhdim të mbledhjes anëtarët e kuvendit dhanë betimin solemn, duke u bërë anëtarë të kuvendit me të drejta të plota.

Gjithashtu betimin solemn para kuvendit e dha edhe kryetari i zgjedhur i Komunës së Vushtrrisë z. Ferit Idrizi.

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë - pasi dha betimin solemn si kryetar i komunës, iu drejtua kuvendit me një fjalim përshëndetës, ku së pari falënderoi qytetarët e Komunës së Vushtrrisë për besimin e dhënë që të udhëheqë komunën, pasi siç deklaroi ata qytetarët besuan në vizonin e tij, në përgatitjen profesionale, sinqeritetin dhe paanësinë e tij. Më tej ai shtoi se bashkë me anëtarët e zgjedhur të kuvendit do të merret me zgjidhjen e problemeve dhe halleve të qytetarëve të Vushtrrisë. Në fund ai duke i falënderuar të gjithë kërkoi nga anëtarët e kuvendit që parasëgjithash të merren me adresimin e interesit qytetar se sa atij partiak, dhe kërkoi nga ta që ashtu siç edhe dhanë betimin e tyre të vazhdojnë së bashku në mbledhjen zgjedhore për votimin në zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit.

3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë (pjesa zgjedhore).

Pas konsultimeve me grupet politike të përfaqësuara në kuvend, kryesuesi i mbledhjes së kuvendit konform Rregullores të punës së kuvendit, vendosi që kuvendi t'i zhvillojë punimet pa prezencën e publikut, për shkak të numrit të madh të qytetarëve dhe vështirësimit të zhvillimit të punimeve të mbledhjes punimet vazhduan në sallën e kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Në vazhdim të mbledhjes në pjesën zgjedhore, kryesuesi i mbledhjes konstatoi se në sallë janë të pranishëm 20 anëtar të kuvendit kuorum i mjaftueshëm për marrjen e vendimeve të plotfuqishme.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-propozoi për anëtar të komisionit për verifikimin e procesit të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë z. Mentor Hasani nga radhët e PDK-së.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-propozoi për anëtar të komisionit për verifikimin e procesit të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë z. Behar Duraku nga radhët e LDK-së.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit- propozoi për anëtare të komisionit për verifikimin e procesit të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë znj. Nurten Çerkezi-Gjyshinca nga radhët e LVV-së.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me 19 vota “për”1 votë “abstenim” aprovoi formimin e komisionit për verifikimin e procesit të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

Mentor Hasani, nga radhët e PDK-së;
Behar Duraku nga radhët e LDK-së;
Nurten Çerkezi-Gjyshinca nga radhët e LVV-së.

Pastaj u hap debati për paraqitjen e propozimeve për kandidat për kryesues të kuvendit:

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar PDK, propozoi znj. Melihate Basholli-Latifi si kandidatë për Kryesuese të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë. Ai vlerësoi se kandidatja në fjalë është një grua intelektuale me përvojë të gjatë në fushën e arsimit, disa mandatet ka shërbyer si anëtare e kuvendit dhe ajo është kredibile dhe do ti bëj nder kuvendit udhëheqja nga ana e saj.

Pas zhvillimit të raundit të parë të votimit, pjesëmarrës në votim ishin 20 anëtar të kuvendit për znj. Melihate Basholli-Latifi kandidatet për kryesuese të kuvendit mori 16 vota “për”, 1 votë “kundër”, 1 votë “abstenim” ndërsa 1 fletëvotim u konstatua si i pavlefshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi rezultoi se kandidatja në fjalë nuk mori votat e mjaftueshme për tu zgjedhur kryesuese e kuvendit.

Në vazhdim u zhvillua raundi i dytë i votimi të fshehtë ku pjesëmarrës në procesin e votimit ishin gjithsej 19 anëtar të kuvendit për znj. Melihate Basholli-Latifi kandidatet e vetme për kryesuese të kuvendit votuan: 18 anëtarë të kuvendit votuan “për” ndërsa 1 “abstenim” në ç’ rast u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim znj.Melihate Basholli-Latifi, anëtare e KK-së zgjedhet Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.
2. Mandati i të lartpërmendurës në cilësinë e kryesueses të kuvendit të komunës përfundon me rastin e përfundimit të mandatit të anëtarëve të KK-së.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Sekretaria e Kuvendit dhe Menaxheri i Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit në kuvendin e komunës dhe pas nënshkrimit nga kryesuesi (anëtari më i vjetër) i mbledhjes së kuvendit.

Melihate Basholli -Latifi, kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë - pasi falënderoi anëtarët e kuvendit për besimin e dhënë që ai të jetë në krye të kuvendit, vlerësoi se ky moment paraqet një sfidë të re për karrierën e saj politike, moment aspak i lehtë e me shumë përgjegjësi. Më tej ajo falënderoj qytetaret e Komunës së Vushtrrisë për besimin e dhënë për disa mandatet që të jetë pjesë e kuvendit dhe po ashtu falënderoj subjektin e saj politik për nominimin për kryesuese të kuvendit, dhe për besimin e dhënë që ta udhëheq kuvendin për katër vitet e ardhshme. Pastaj ajo u zotua se me nder dhe përgjegjësi të lartë do ta kryen detyrën e kryesuese të kuvendit duke respektuar me përpikëri ligjet dhe rregulloret në fuqi. Synon që së bashku me anëtarët e kuvendit në koordinim me kryetarin e komunës dhe qeverinë komunale të jenë në shërbim të qytetarëve të komunës sonë pa dallim, duke punuar me përkushtim për ngritjen e mirëqenies së tyre në të gjitha sferat e jetës bashkë na priftë e mbara!

Mbledhja përfundoi në ora 13:30.

Bastri Duraku

Ali Januzi

Procesmbajtës

Anëtar i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 14 JANAR 2022

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Munguan: Gresa Muli dhe Shkelzen Xhaferi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – Kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 33 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës - z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës - z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Në fillim të mbledhjes, anëtarët e rinj të kuvendit: Agim Bregaj, Spasoje Stefanoviq, Zojë Hajrizi dhe Blerina Shala, dhanë betimin para anëtarëve të kuvendit, duke marrë mandatin e anëtarit të kuvendit me të drejta të plota.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - pasi përshëndeti të pranishmit veçanërisht anëtarët e kuvendit, ju uroi shëndet e suksese në këtë legjislaturë, duke u zotuar para tyre se do jetë bashkëpunues me të gjithë, me qëllim që t'i shtyjnë përpara proceset në interes të përgjithshëm qytetar. Ai shtoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë kanë mbi supet e tyre përgjegjësi për t'i mbajtur dhe realizuar premtimet që i kanë marrë përsipër në fushatë zgjedhore. Në fund njoftoi se së shpejti para kuvendit do të silllet programi i qeverisë dhe do të fillohet me

punët që na presin në realizimin e objektivave që dalin nga programi i qeverisë në mandatin katërvjeçar.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - të nderuar anëtarë të kuvendit! I nderuar Kryetar i komunës z. Ferit Idrizi, nënkryetar i komunës z. Shpëtim Zhegrova, kryesuese e kuvendit z. Melihate Basholli - Latifi, kabinet qeveritar, drejtorë e drejtoresha të drejtorive. Të respektuar zyrtarë tjerë komunal, dhe ju të pranishëm! Të nderuar dhe shumë të respektuar qytetarë të Komunës së Vushtrrisë. Sot, në këtë mbledhje të parë të jashtëzakonshme pas asaj inauguruese, dëshiroj të theksoj që kjo seancë e kuvendit ka koloritin e një seance solemne dhe procedurale sipas rendit të ditës, ftoj dhe besoj në rrjedhën kronologjike dhe votim numerik të rendit të ditës dhe me krenari them se pritshmëria e qytetarëve gjatë fushatës po edhe në rastin e formimit të qeverisë komunale dhe fillimit të punës e ofrimit të shërbimeve nga qeveria e PDK-së, janë shumë të mëdha dhe të mirëpritura. Rikthimi i PDK-së, ishte alternativa e vetme qeverisëse për Vushtrrinë, andaj unë ju them qytetarëve se Kryetari Idrizi bashkë me PDK-në ka përzgjedhur qeverinë komunale, duke mbajtur premtimet elektorale, fillimisht duke respektuar marrëveshjet në masën 100% me partitë politike të koalicionit. Ekipi qeverisës, i cili do të udhëheq me drejtoritë për herë të parë në historinë e pasluftës, ka një përfaqësim reprezentativ gjithëpërfshirës dhe një drejtor që do të udhëhiqet nga një doktor shkence z. Remzi Ahmeti, drejtoritë tjera kanë në përmbajtje profesionist të fushës, nëna, vajza, burra e djem të përkushtuar, dy drejtor do të udhëhiqen nga njëri partner i koalicionit nga AAK-ja, kurse një tjetër drejtor do të udhëhiqet nga partneri tjetër i koalicionit. Nisma Socialdemokrate, një drejtor udhëhiqet nga shoqëria civile, e kam fjalën për Drejtorinë e Urbanizmit, ajo e bujqësisë nga partia turke, po kemi edhe Drejtorinë e Kulturës që do të udhëhiqet nga një e re intelektuale, profesioniste dhe artdashëse, znj. Medina Bunjaku! Andaj, urime Kryetar z. Ferit Idrizi, urime drejtorë e drejtoresha, urime qytetarë të Vushtrrisë! Në këtë rast dëshiroj të përgëzoj dhe falënderoj të gjithë qytetarët e Vushtrrisë që besuan tek ne, dhe në subjektin tonë politik, besuan në platformën politike të PDK-së, na votuan me çka rikthyem pushtetin me kandidatin tonë për kryetar komune z. Ferit Idrizi, si dhe kemi një përfaqësim të kënaqshëm në Kuvendin komunal me 11 deputetë të zgjedhur. Kjo është një e arritur konstante, sukses e përgjegjësi sepse qytetarët na votuan dhe na besuan se do të jemi zëri i tyre, mbrojtës të interesave të përgjithshme, fundja me votë na kanë dhënë obligime, dhe ne jemi këtu që të respektojmë këtë lidhje sa fisnike aq edhe hyjnore me qytetarin dhe për qytetarin. Në këtë rrafsh mendoj, pres dhe ftoj edhe opozitën që të jemi të rreshtuar së bashku në shërbim të qytetarëve, duke tejkaluar interesat e ngushta klanore e partiake në mënyrë që ne si kuvend të marrim mbi supet tona krejt atë që kemi obligim, kompetencë e përgjegjësi ligjore e njerëzore në të mirë të qytetarëve, dhe unë po kërkoj që punën tonë ta bëjmë në mënyrën më të mirë të mundshme dhe me përkushtim, çdoherë duke u bazuar në ligj dhe në të mirën e përgjithshme. Falemnderit për mirëkuptimin tuaj! Na priftë e mbara!

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit - sqaroi se në bazë të fuqisë së votës të subjekteve politike, të marrë në zgjedhjet e fundit, është përgatitur çelësi i përbërjes së Komitetit

për Politikë dhe Financa dhe në bazë të përqindjeve del se: PDK-së i takojnë 3 anëtarë, LDK-së i takojnë 3 anëtarë dhe LVV-së i takojnë 2 anëtarë, prej këtyre në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore, PDK obligohet të propozojë 2+1 d.th 2 burra dhe 1 grua, LDK, obligohet të propozojë 2+1, ndërsa LVV-ja obligohet të propozojë 1+1, d.m.th në përbërje të Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të propozojë 1 burrë dhe 1 grua.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit - pasi përshëndeti të pranishmit, shtoi se grupi i tij kuvendar, nuk pajtohet me formulën e propozuar nga kryesuesja e kuvendit lidhur me përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa. Pastaj shtoi se bazuar në legjislacionin në fuqi Komitetit për Politikë dhe Financa për ato komuna që kanë mbi 31 anëtarë të kuvendit duhet t'i kenë 9 anëtarë në KPF, dhe se formula e propozuar prej kryesueses së kuvendit 3+3+2=8, bie në kundërshtim me specifikat ligjore që e rregullojnë këtë fushë. Trajtimi në mënyrë të ndarë i vendit të kryesuesit të kuvendit në KPF është i papranueshëm, për arsye se kryesuesi i kuvendit gjatë mandatit mund të jap dorëheqje ose mund të shkarkohet dhe në këto raste i ruhet pozicioni i të zgjedhurit në KPF, andaj kjo krijon një disballanc dhe shpërputhje ligjore me përfaqësimin real të forcave politike që janë në kuvend. Kështu si grup kuvendar i LVV-së propozojnë që formula apo çelësi duhet të jetë 3+3+3=9 e ndarë në mënyrë të barabartë mes tri subjekteve më të mëdha politike të përfaqësuara në kuvend.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se Ligji për Vetëqeverisje Lokale e ka rregulluar çështjen e përfaqësimit në KPF, dhe e vërteta është se kryesuesi i kuvendit me automatizëm është edhe kryesues i KPF-së sipas detyrës zyrtare dhe shkarkimi apo dorëheqja e kryesuesit të kuvendit nënkupton dorëheqje apo shkarkim edhe nga pozitat e kryesuesit të KPF. Kjo është kështu sepse ligji e rregullon një gjë të tillë, ndërsa sa i përket përqindjeve të votave të fituara dhe shndërruar në ulëse në kuvend dhe në KPF, ai vlerësoi se në asnjë modalitet dhe alternativë, grupit kuvendar të LVV-së nuk i takojnë më shumë se dy anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit - tha se bazuar në udhëzimin administrativ për komitetet obligative, çelësi i propozuar nga partia në pushtet, por edhe ai i propozuar nga grupi kuvendar i LVV-së, nuk është real, është joparimor dhe jofunksional sipas legjislacionit në fuqi. Pastaj shtoi se në çdo modalitet shihet se legjislacioni përcakton që komiteti duhet të jetë gjithëpërfshirës. Kjo në të kaluarën nuk ka qenë traditë dhe për këtë edhe ka pasur ankesa dhe vendimet e kuvendit janë shpallur të kundërligjshme për shkak të mosrespektimit të udhëzimit administrativ. Në komitet duhet të jenë të përfshira të gjitha entitetet politike, dhe problem do të kishim atëherë kur numri i entiteteve do të ishte më i madh se sa numri i votueseve, komuna jonë nuk e ka një problem të tillë sepse ajo ka 7 entitete politike të përfaqësuara në kuvend, ndërsa numri i anëtarëve të KPF-së është 9 gjithsej. Tutje vlerësoi se kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa nuk llogaritet në çelësin e komitetit, ndërsa bëhet fjalë tani për 6 subjektet politike, të cilat duhet t'i kenë përfaqësuesit e tyre në komitet, për faktin se përfaqësuesi i entitetit serb duhet të jetë pjesë e Komitetit për Komunitete. Andaj sipas tij, çelësi i themelimit të KPF-së duhet të jetë si në vijim: PDK-ja duhet t'i ketë 2 përfaqësues + kryesuesja, LDK-ja duhet t'i ketë 2 përfaqësues, LVV-ja 2, ndërsa nga 1 përfaqësues duhet t'i kenë AAK-ja, Nisma dhe LB-ja.

Mek Selaci, anëtar i kuvendit - pyeti se si është e rregulluar që udhëzimi administrativ t'i mundësojë përfaqësuesit serb të jetë me automatizëm anëtar i Komitetit për Komunitete.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit - duke iu referuar Udhëzimit administrativ për themelimin e komiteteve, shtoi se nëse në kuvendin e komunës nuk ka mundësi që të përfshihen të gjitha entitetet politike, atëherë ndarja e vendeve në KPF bëhet sipas numrit të përfaqësuesve të partive politike që i kanë në kuvend. Pra numri i anëtarëve të kuvendit të fituar nga një subjekt politik

është një element matës determinues dhe pamohueshëm për përbërjen e KPF-së dhe mbi të gjitha ky është një vullnet qytetar që ka votuar ditën e zgjedhjeve për këta përfaqësues kushdo që janë. Andaj nuk mund të shkelet forca e votës dhe fuqisë politike që qytetarët kanë përfaqësuar. Lidhur me formulën e propozuar nga PDK-ja, ceku se kjo nuk është reale sepse kryesuesen e kuvendit e trajton si të ndarë dhe shtoi se me këtë formulë PDK me 11 anëtarë të kuvendit të fituar me vetëm 2.75 asamblistë fiton 1 vend në KPF, me formulën që LDK merr 3 përfaqësues në KPF mesatarisht me 3.66 asamblistë fiton një 1 vend në Komitetin për Politikë dhe Financa, ndërsa me formulën e propozuar LVV-së i duhen 4.5% të asamblistëve për ta fituar një 1 vend në KPF, pra edhe matematikisht kjo gjë nuk është e drejtë të jetë kështu. Andaj ai krejt në fund përsëriti se formula më e drejtë dhe parimore është $3+3+3=9$, përfaqësimi nga tri forcat kryesore politike të përfaqësuara në kuvendin e komunës, të përfaqësohen edhe në KPF me nga tre (3) anëtarë.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës - tha se si subjekt politik që i kanë fituar zgjedhjet së bashku me partnerët e koalicionit, nuk dëshirojnë të shkojnë në arrogancën e numrave, sepse kjo ka ndodhur në mandatin e kaluar kur PDK kishte 12 anëtarë të kuvendit, ajo kishte marrë vetëm dy vende në KPF dhe kjo ishte bërë me ndihmën e LVV-së e bashkë me Xhafer Tahirin jo me LDK, duke u bazuar pikërisht në arrogancën e numrave dhe pavarësisht asaj PDK nuk kishte bërë fare ankesë. Në të gjitha kombinatorikat prapë shumica mbetet në opozitë, sepse 3 vende i takojnë LDK-së, ndërsa 2 vende Lëvizjes Vetëvendosje dhe kjo i bie se shumica në KPF është prapë tek opozita. Por nëse i referohemi përqindjeve gjërat dalin akoma më ndryshe, sepse 8 anëtarë të KPF-së duhet të zgjedhen sepse kryesuesja e kuvendit shkon sipas detyrës zyrtare dhe në bazë të përqindjeve të votave del se: PDK ka 31.33% të votave që i bie 2.51 anëtarë për përfaqësim në KPF që i bie 3 anëtarë në përbërjen e KPF-së, LDK-ja ka 2.48 të anëtarëve të kuvendit në bazë të përqindjeve të votave për kuvend të komunës që i bie se duhet të përfaqësohet me 2 anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa, por nuk janë shkuar me këtë formulë për mos të treguar arrogancë, por formula është në bazë të numrit të ulëseve të fituara në kuvend.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit - pasi falënderoi të gjithë të pranishmit, iu uroj suksese qeverisë dhe kuvendit, shtoi se si opozitë do t'i përkrahin të gjitha propozimet dhe projektet që janë në interes të përgjithshëm qytetar, ndërsa do të jenë zë kritik për të gjitha ato projekte për të cilat mendojnë se janë në dëm të interesit të përgjithshëm. Lidhur me pikën e rendit të ditës kërkoi 5 minuta pauzë për konsultim mes grupeve kuvendare.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - pasi përshëndeti të pranishmit njoftoi kuvendin se shef i grupit kuvendar të LVV-së është Sylejman Mehulli, ndërsa sa i përket çelësit për themelimin e KPF-së ai vlerësoi se oferta e propozuar nga LVV-ja është më e mira dhe më e drejta, sepse vërtet nuk ka kuptim që PDK-ja që ka 11 anëtarë të kuvendit, t'i ketë 4 anëtarë në KPF, kurse LVV-ja që ka 9 anëtarë të kuvendit të përfaqësohet me vetëm 2 anëtarë në KPF. Duhet të pranohet fakti se janë tri forca politike në kuvend që posedojnë 31 anëtarë të kuvendit dhe kjo i bie se 90% të përbërjes së kuvendit vjen nga PDK, LDK dhe LVV. Andaj formula $3+3+3=9$ është formula më e drejtë dhe kjo duhet të vendoset kështu për hir të transparencës dhe për hir të bashkëpunimit të sinqertë mes forcave politike në kuvend.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit - tha se në bazë të konsultave mes grupeve, grupi kuvendar i LVV-së nuk u pajtua me çelësin e propozuar sepse konsideron se nëse LVV-së nuk i takojnë 3 anëtarë në KPF, atëherë as PDK-së nuk i takojnë 4 anëtarë. Tendencë që kryesuesja e kuvendit të nxirret jashtë çelësit të përbërjes dhe përkatësisë partiake të KPF-së është e

paprecedent dhe nuk është praktikë ligjore, andaj kjo çështje mund të procedohet për votim dhe aprovim, porse grupi i LVV-së do të ankohet në MAPL, për shkelje sa i përket kësaj pike.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit e hodhi në votim çelësin e themelimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe atë PDK 3 + kryesuesja e kuvendit, LDK 3 anëtarë, dhe LVV 2 anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa. Lidhur me këtë propozim, 25 anëtarë të kuvendit votuan “për” ndërsa 8 vota ishin “kundër” dhe kështu u aprovua çelësi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mentor Hasani, anëtar i kuvendit - tha se në koordinim me grupin e tyre kuvendar, janë dakorduar, që përfaqësuesit e tyre në KPF të jenë: Nurie Halili, Ilmi Azemi dhe Lorik Maxhuni.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit - propozoi për anëtarë të KPF-së Edona Gashin, Fakte Dushin dhe Adnan Lahun.

Behar Duraku, anëtar i kuvendit - në emër të LDK-së, për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa propozoi: Agron Përçukun dhe Alban Bajramin.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar të LVV-së, për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa propozoi: Fatmire Cecelinë dhe Sylejman Mehullin.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit - tha se propozimi i tij është i dhënë në emër të grupit të LDK-së, ndërsa propozimet tjera nga LDK-ja nuk mund të jenë të vlefshme.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit - tha se është e patjetërsueshme që secili nga anëtarët e kuvendit dhe secili anëtar i LDK-së, i përfaqësuar në kuvend ka të dejtë të propozojë dhe të jetë i propozuar për përfaqësues në Komitetin për Politikë dhe Financa

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit, propozimet për anëtarë të KPF-së nga radhët e LDK-së i procedoi në votim në mënyrë individuale. Për Edona Gashin 5 vota ishin “për”, ndërsa 18 vota ishin “kundër” dhe ky propozim nuk aprovohet, për Fakte Dushin 18 vota ishin “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim dhe propozimi i tillë aprovohet, për Adnan Lahun 6 vota ishin “për” 24 vota ishin “kundër”, propozim i tillë nuk aprovohet, për Agron Përçukun 20 vota ishin “për”, ndërsa 8 vota “kundër”, propozimi aprovohet, për Alban Bajramin 24 anëtarë të kuvendit votuan “për”, 7 “kundër” dhe propozimi i tillë aprovohet.

Më pas kryesuesja e kuvendit e hodhi në votim në tërësi propozimin për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në ç’ rast kuvendi me 27 vota “për”, të tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa nga radhët e anëtarëve të kuvendit të komunës, në këtë përbërje:

1.1 Melihate Basholli Latifi, – Kryesuese e KPF nga radhët e PDK;

1.2 Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së nga radhët e PDK-së;

1.3 Lorik Maxhuni, anëtar i KPF-së nga radhët e PDK-së;

1.4 Nurie Halili, anëtare e KPF-së nga radhët e PDK-së;

1.5 Agron Përçuku, anëtar i KPF-së nga radhët e LDK-së;

1.6 Alban Bajrami, anëtar i KPF-së nga radhët e LDK-së;

1.7 Fakte Dushi, anëtare e KPF-së nga radhët e LDK-së;

**1.8 Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së nga radhët e LVV-së dhe
1.9 Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së nga radhët e LVV-së;**

2. Komiteti për Politikë dhe Financa, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë, Statutin e komunës, aktet tjera, si dhe rregulloren e punës.
3. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të kuvendit të komunës përveç nëse ky mandat pushon në rastet e parapara me legjislacionin në fuqi.
4. Anëtarët e KPF-së, për pjesëmarrje në mbledhje do të kompensohen sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.
5. Ky vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora: 11:16

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Melihate Basholli Latifi



Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATË/A:	18.01.2021
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës
PËRMES	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës 
NGA/OD/FROM:	Abit Abiti, Zyrtar Kryesor Financiar 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport tremujor, Janar – Dhjetor 2021

Në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur raportin tremujor, i cili mbulon vitin fiskal e deri në fund të këtij tremujori që sapo ka përfunduar. Ky raport përmban shënime mbi arkëtimet, shpenzimet dhe një përmbledhje të shpenzimeve kapitale. Këtë raport e prezantojmë para Kuvendit Komunal, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komunës.

Me respekt!

Shtojcë raportet:

Emri i Komunës :	K.K.VUSHTRRI								
Kodi i Komunës:	644								
Periudha raportuese	Janar - Dhjetor	2021							

TE HYRAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK

Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese			Vjetore					Viti i kaluar
		Buxheti i planifikuar për PR	Të hyrat e realizuar në PR	Përqindja e buxhet të realizuar për PR	Buxheti I planifikuar për 2021	Buxheti I mbetur për 2021	Plani I reviduar	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe reviduar	Te hyrat e realizuara ne periudhen e njejte 2020	
		4	5	6 = 5/4*100	7	8 = 7-5	9	10 = 7-9	11	
Administrata dhe personeli	163	€	€	%	€	€	€	€	€	
Taksa administrative		70,000.00	75,211.00	107%	70,000.00	-5,211.00	0.00	70,000.00	51,858.00	
TOTAL		70,000.00	75,211.00	107%	70,000.00	-5,211.00	0.00	70,000.00	51,858.00	
Inspeksioni	166	€	€	%	€	€	€	€	€	
Pranimet teknike		5,000.00	3,358.00	67%	5,000.00	1,642.00	0.00	5,000.00	22,643.45	
Pelqimet sanitare		6,000.00	16,527.49	275%	6,000.00	-10,527.49	0.00	6,000.00		
Gjobat e inspeksionit		1,000.00	8,287.16	829%	1,000.00	-7,287.16	0.00	1,000.00		
TOTAL		12,000.00	28,172.65	235%	12,000.00	-16,172.65	0.00	12,000.00	22,643.45	
Buxhet dhe Financa	175	€	€	%	€	€	€	€	€	
Taksat e firmave		15,000.00	15,590.00	104%	15,000.00	-590.00	0.00	15,000.00	16,309.00	
Tatimi në pronë		923,124.00	895,449.83	97%	923,124.00	27,674.17	0.00	923,124.00	734,351.70	
TOTAL		938,124.00	911,039.83	97%	938,124.00	27,084.17	0.00	938,124.00	750,660.70	
Arsimi	900	€	€	%	€	€	€	€	€	
Shitja e prodhimeve									600.00	
Participimi në gerdhen e fëmijëve		45,000.00	31,622.00	70%	45,000.00	13,378.00	0.00	45,000.00	6,831.00	
Shkolla e Mesme Teknike		15,000.00	12,717.00	85%	15,000.00	2,283.00	0.00	15,000.00	12,758.00	

Shkolla e Mesme Profesionale	14,000.00	18,050.10	129%	14,000.00	-4,050.10	0.00	14,000.00	17,230.00
TOTAL	74,000.00	62,389.10	84%	74,000.00	11,610.90	0.00	74,000.00	37,419.00
Gjeodezi dhe Kadastër	650	€	%	€	€	€	€	€
Qiraja nga objektet publike	23,000.00	2,155.00	9%	23,000.00	20,845.00	0.00	23,000.00	€
Të hyrat nga Gjeodezia dhe Kadastri	50,000.00	126,115.62	252%	50,000.00	-76,115.62	0.00	50,000.00	96,857.47
TOTAL	73,000.00	128,270.62	176%	73,000.00	-55,270.62	0.00	73,000.00	96,857.47
Kulturë, rini dhe sport	850	€	%	€	€	€	€	€
Palestra e sportit	1,000.00	636.00	64%	1,000.00	364.00	0.00	1,000.00	756.00
Biblioteka	500.00	232.00	46%	500.00	268.00	0.00	500.00	37.00
Shtëpia e Kulturës	1,000.00	335.00	34%	1,000.00	665.00	0.00	1,000.00	€
TOTAL	2,500.00	1,203.00	48%	2,500.00	1,297.00	0.00	2,500.00	793.00
Shërbime publike	180	€	%	€	€	€	€	€
Parkingjet	2,000.00	1,450.00	73%	2,000.00	550.00	0.00	2,000.00	3,719.45
Taksat per Mbeturina	405,279.00	495,801.54	122%	405,279.00	-90,522.54	0.00	405,279.00	470,999.59
Taksat rrugore	83,000.00	130,700.50	157%	83,000.00	-47,700.50	0.00	83,000.00	113,691.50
TOTAL	490,279.00	627,952.04	128%	490,279.00	-137,673.04	0.00	490,279.00	588,410.54
Prokurimi		1,751.82	#DIV/0!			0.00		
TOTAL		1,751.82	#DIV/0!			0.00		0.00
Bujqësi	470	€	%	€	€	€	€	€
Ndryshimi i destinimit të tokës	10,000.00	76,452.19	765%	10,000.00	-66,452.19	0.00	10,000.00	113,783.28
Leje pune		30.00						30.00
TOTAL	10,000.00	76,482.19	765%	10,000.00	-66,452.19	0.00	10,000.00	113,813.28
Shëndetësi	700	€	%	€	€	€	€	€
Participim	50,000.00	57,188.50	114%	50,000.00	-7,188.50	0.00	50,000.00	28,445.50
Participim QPS	2,000.00	4,130.00	207%	2,000.00	-2,130.00	0.00	2,000.00	2,681.00
TOTAL	52,000.00	61,318.50	118%	52,000.00	-9,318.50	0.00	52,000.00	31,126.50
Urbanizmi	660	€	%	€	€	€	€	€
Lejet e ndërtimit	180,000.00	533,178.24	296%	180,000.00	-353,178.24	0.00	180,000.00	407,136.57
leje mjedisore		63,898.72						
Legalizim i Objekteve		18,365.90						
Rrenim i objekteve		1,169.50						
Shfrytëzimi i pronës Publike	5,000.00	14,372.67	287%	5,000.00	-9,372.67	0.00	5,000.00	511.25

TOTAL		185,000.00	630,985.03	341%	185,000.00	-362,550.91	0.00	185,000.00	407,647.82
	850	€	€	%	€	€	€	€	€
Gjobat e trafikut			359,274.50	#DIV/0!			0.00	0.00	137,822.50
Gjobat e gjykatave			17,850.00	#DIV/0!			0.00	0.00	10,845.00
Gjobat e pyjeve			973.00						
Të hyrat tjera			66,014.33	#VALUE!		-66,014.33	0.00	0.00	658.00
TOTAL		0.00	444,111.83	#DIV/0!	0.00	-66,014.33	0.00	0.00	149,325.50
		1,906,903.00	3,047,135.79	160%	1,906,903.00	-1,140,232.79	0.00	1,906,903.00	2,250,555.26

Emri i Komunës :		K.K.Vushtri										
Kodi i Komunës:		644										
Periudha raportuese		Janar - Dhjetor										
PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT												
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE					VIETORE					
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2021	Buxheti i mbetur për 2021	Plani i reviduar 2021	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Viti i kaluar			
		4	5	6 = 5/4*100 %	7	8=7-5	9	10 = 7-9	11			
		€	€	%	€	€	€	€	€			
Finacimi nga huamarrjet	04	54,186.70	52,937.32	98%	54,186.70	1,249.38	0.00	54,186.70	150,059.85			
Granti Qeveritar	10	16,729,049.73	15,663,820.05	94%	16,729,049.73	1,065,229.68	0.00	16,729,049.73	16,682,866.32			
Të hyrat vetanake	21	1,906,902.75	1,086,127.98	57%	1,906,902.75	820,774.77	0.00	1,906,902.75	1,010,909.11			
Mjeteret e bartura	22	1,789,251.83	1,176,102.73	66%	1,789,251.83	613,149.10	0.00	1,789,251.83	787,396.18			
Donacionet e brendshme	31	69,481.18	17,479.95	6%	69,481.18	52,001.23	0.00	69,481.18	238,846.11			
Donacionet e jashtme	32	312,942.70	301,757.87	96%	312,942.70	11,184.83	0.00	312,942.70	81,343.83			
TOTALI		20,861,814.89	18,298,225.90	88%	20,861,814.89	2,563,588.99	0.00	20,861,814.89	18,951,421.40			

Komuna	VUSHTRRI											
Kodi	644											
Periudha raportuese	Janar - Dhjetor											
PËRMLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE TË LARTA TË SHPENZIMEVE												
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE			Viti i kaluar				
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2021	Buxheti i mbetur për 2021	Plani i reviduar 2021	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi i realizuar për periudhën e njëjtë 2020			
		4	5	6 = 5/4*100	7	8 = 7-5	9	10 = 7-9	11			
		€	€	%	€	€	€	€	€			
Paga dhe mëditje	111	10,603,183.40	10,603,183.40	100%	10,603,183.40	0.00	0.00	10,603,183.40	10,313,007.40			
Mallra dhe shërbime	130	3,842,777.42	3,110,540.88	81%	3,842,777.42	732,236.54	0.00	3,842,777.42	3,153,416.61			
Shpenzimet komunale	132	334,376.22	309,362.05	93%	334,376.22	25,014.17	0.00	334,376.22	239,622.65			
Subvencionet dhe transferet	200	1,007,004.93	836,991.44	83%	1,007,004.93	170,013.49	0.00	1,007,004.93	690,049.07			
Investimet kapitale	300	5,074,472.92	3,438,148.13	68%	5,074,472.92	1,636,324.79	0.00	5,074,472.92	4,320,959.55			
TOTALI		20,861,814.89	18,298,225.90	88%	20,861,814.89	2,563,588.99	0.00	20,861,814.89	18,717,055.28			

Emri i Komunës :	VUSHTRRI																		
Kodi i Komunës:	644																		
	Janar - Dhjetor																		
Periudha raportuese																			
PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE																			
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE				VJETORE				Viti i kaluar									
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti I planifikuar për 2021	Buxheti I mbetur për 2021	Plani I reviduar 2021	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2020										
		€	€	%	€	€	€	€	€										
Zyra e Kryetarit	160	495,014.86	429,092.93	87%	495,014.86	65,921.93	0.00	495,014.86	377,699.14										
Administrata dhe personeli	163	401,070.72	347,928.08	87%	401,070.72	53,142.64	0.00	401,070.72	315,324.91										
Inspektimet	166	137,250.87	112,198.99	82%	137,250.87	25,051.88	0.00	137,250.87	94,931.06										
Prokurimi	167	37,913.48	31,663.96	84%	37,913.48	6,249.52	0.00	37,913.48	38,019.58										
Zyra e Kuvendit Komunal	169	142,882.89	135,142.11	95%	142,882.89	7,740.78	0.00	142,882.89	119,812.70										
Buxheti dhe financat	175	171,410.92	156,479.27	91%	171,410.92	14,931.65	0.00	171,410.92	157,073.14										
Projektime dhe emergjence	180	3,936,889.69	3,509,000.37	89%	3,936,889.69	427,889.32	0.00	3,936,889.69	3,303,297.32										
Zyra tokave e komuniteteve	195	60,232.97	41,408.56	69%	60,232.97	18,824.41	0.00	60,232.97	41,701.65										
Bujqesi, pylltari, zhvillimi rural	470	858,410.16	474,938.40	55%	858,410.16	383,471.76	0.00	858,410.16	879,344.41										
Gjeodezi dhe Kadasër	650	81,826.72	77,598.40	95%	81,826.72	4,228.32	0.00	81,826.72	120,891.98										
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	1,514,348.57	1,059,664.57	70%	1,514,348.57	454,684.00	0.00	1,514,348.57	798,273.64										
Shëndetësi primare	730	2,724,782.17	2,398,442.71	88%	2,724,782.17	326,339.46	0.00	2,724,782.17	2,924,575.92										
Shërbimet sociale rezidenciale		322,152.92	204,562.19	63%	322,152.92	117,590.73	0.00	322,152.92	262,974.79										
Kulturë, rini, sport	850	514,649.86	335,420.50	65%	514,649.86	179,229.36	0.00	514,649.86	481,098.65										
Arsimi	920	9,462,978.09	8,984,684.86	95%	9,462,978.09	478,293.23	0.00	9,462,978.09	9,096,402.51										
TOTALI		20,861,814.89	18,298,225.90	88%	20,861,814.89	2,563,588.99	0.00	20,861,814.89	18,951,421.40										

Emri i Komunës :
 Kodi I komunës:
 Periudha raportuese

VUSHTRRI
 644
 Janar - Dhjetor 2020

KODI	Mallrat dhe shërbimet	2020	2021
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	400.00	1,076.45
13132	Akomodimi i udhëtimit zyrtar brenda vendit	80.00	768.00
13133	Shpenzimet e tjera të-udhëtimit zyrtar brenda vendit		10.76
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit	9,564.90	700.00
13141	Shpenzimet të vogla -para xhepi	1,834.64	1,612.00
13142	Akomodimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit	514.64	810.00
13143	Shpenzimet tjera e udhëtimit zyrtar jasht vendit	38.33	351.00
13310	Shpenzimet për internet	3,076.96	2,936.07
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	22,265.44	25,527.24
13330	Shpenzimet postare	2,174.80	12,936.53
13410	Shpenzimet e arsimit dhe trajnimit	2,200.00	
13420	Shërbimet e perfaqsimi - avokaturë		94.40
13430	Shërbime të ndryshme shendetësore	3,239.34	6,351.54
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	140,422.00	32.00
13450	Shërbime shtypje - jo marketing	104.21	
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	1,526,588.99	1,831,096.21
13470	Shërbime teknike	400.00	1,867.17
13780	Shpenzimet për antarsim	14,937.00	17,480.50
13490	Shërbimet e varrimit	105,240.00	107,460.00
13501	Mobilje (më pak se 1000 euro)	18,119.00	17,402.40
13503	Kompjuter (më pak se 1000 euro)		93,234.10
13504	Harduer për teknike informative (më pak se 1000 euro)	989.00	332.36
13508	paasje trafiku (më pak se 1000 euro)		363.00
13509	paasje tjera (më pak se 1000 euro)		63,660.57
13506	Pajisje specialistike mjeksore	99.00	
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	34,297.78	
13510	blerja e librave edhe veprave artistike		2,399.00
13610	Furnizime për zyrë	69,556.39	93,541.68
13611	Furnizim me dokumenta blanko	4,350.00	5,600.00
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	58,020.25	29,985.35
13630	Furnizime mjekësore	105,906.24	109,423.41
13640	Furnizime pastrimi	59,982.69	23,663.01
13650	Furnizim me veshmbathje	11,698.90	13,306.00
13655	Furnizim me preparate kimike	2,973.09	2,071.50
13710	vaj		726.00
13720	Nafte per ngrohje qendrore	44,418.14	56,099.41
13730	Vaj per ngrohje qendrore	775.00	
13760	Dru	47,313.00	190,589.24
13770	Derivate per gjenerator	2,968.50	2,202.06
13780	Karburant per vetura	40,359.53	42,091.28
13790	Gas natyror	99.00	198.65

13810	Avanc për para të imta	4,700.00	4,000.00
13820	Avanc për udhëtime zyrtare	281.88	2,118.53
13918	Provizion për tarifa të ndryshme	7,023.50	4,688.50
13950	Regjistrimi i automjeteve	3,380.00	4,075.00
13951	Sigurimi i automjeteve	5,354.79	4,843.45
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	28,733.75	34,120.66
14020	Mirembajtja e ndertesave	8,223.25	4,271.34
14022	Mirembajtja e ndertesave afariste		877.50
14023	Mirembajtja e shkollave	16,477.96	36,248.27
14024	Mirembajtja e objekteve shëndetësore	1,956.59	7,434.03
14032	Mirembajtja e auto rrugeve lokale	5,934.00	20,254.20
14040	Mirembajtja e teknologjisë informative	1,209.55	3,292.31
14050	Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve	13,563.64	27,006.11
14060	Mirembajtja rutinore	18,751.80	83,913.40
14110	Qiraja per ndertesa	270.00	1,440.00
14130	Qiraja - pajisjet	6,894.31	8,318.55
14140	Qiraja -makineria	18,014.45	18,684.52
1415	Qiraja- përdorime tjera të hapsirave		950.00
14210	Reklamat dhe konkurset	2,891.30	1,742.49
14220	Botimet e publikimeve	928.00	1,480.02
14230	Shpenzimet per informim publik	3,262.60	15,569.60
14310	Drekat zyrtare	17,065.30	31,183.68
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	717,648.07	7,271.64
14415	Pagesat për tarifrat-vendimet gjyqësore- përmbartimore		2,119.28
14510	Pagesa e tatimit në qira		1,878.00
17000	Pagesa e borgjit qeveritar		24,760.91
13 TOTALI PËR MALLRA DHE SHËRBIME		3,217,571.50	3,110,540.88

14			
13210	Rryna	175,072.35	231,376.25
13220	Uji	33,313.02	38,959.32
13230	Mbeturinat	23,051.39	30,581.21
13250	Shpenzimet telefonike	8,185.89	8,445.27
13260	Pagesa-vendime gjyqësore		
14 TOTALI I SHPENZIMEVE KOMUNALE		239,622.65	309,362.05

20	SUBVENCIONET		
21110	SUBVENCIONE PËR ENTITETET PUBLIKE	86,408.80	182,836.11
21120	SUBVENCIONE PËR ENTITETET PUBLIKE (TEATËR, BIBLIOTEK)		
21200	SUBVENCIONE PËR ENTITETET JOPUBLIKE	603,640.27	654,035.33
20 TOTALI I SUBVENCIONEVE		690,049.07	836,871.44
TOTALI I SHPENZIMEVE OPERATIVE		4,147,243.22	4,256,774.37

8. Shpenzimet e projekteve kapitale		Vshirimi		Janar - Dhjetor	
Kodi i Projektit	Emri i projektit	Vlera totale e projektit	Shpenzimet në PR	Shuma e mbetur	% e mjetëve të shpenzuar
163	ADMINISTRATA DHE PERSONELI	10,000.00	7,435.36	2,564.64	74.35
43889	43809 TEKNOLOGJI INFORMATIVE	2,800.00	0.00	2,800.00	-
49498	43890 Inventar per Objekte e Rre te Komunes	3,440.00	3,440.00	-	100.00
47815	50752 E-KIOSJET	10,000.00	5,592.50	4,407.50	55.93
49479	50960 INVENTAR PER PROJEKTE TE REJA	5,000.00	0.00	5,000.00	-
TOTALI		31,240.00	16,467.86	14,772.14	52.71
180	SHERBIMET PUBLIKE MBROJTJA CIVILE EMERGJENCAT	72,000.00	49,030.11	22,969.89	68.10
41406	41406 NDERTIMI I RRUGEVE ME KUBZA BETONI	51,000.00	46,276.14	4,723.86	90.74
41407	41407 NDERTIMI I TROTUARREVE	39,974.95	39,974.35	0.60	100.00
41413	41413 NDRIMI PUBLIK	72,621.46	66,858.50	5,762.96	92.06
41415	41415 NDERTIMI I KANALIZIMEVE	175,000.00	145,000.00	30,000.00	82.86
43900	43900 Projekti ne bashkefinancim me donator	165,888.73	144,693.93	21,194.80	87.22
46883	46883 NDERTIMI I IMPIANTIT	20,000.00	0.00	20,000.00	-
46802	46802 NDERTIMI I SHITRATIT TE LUMIT "PODRINCA" ME INFRASTRUKTURE	25,120.00	0.00	25,120.00	-
46628	46628 ZGJERIMI I RREJITIT TE UJESJELLESIT	530,030.00	405,991.49	124,038.51	76.60
47826	47826 NDERTIMI STACIONIT TE AUTOBUSEVE	50,000.00	0.00	50,000.00	-
47838	47838 NDERTIMI I TREGUT PER PRODHUES VENDORE	10,000.00	0.00	10,000.00	-
47893	47893 KAMERAT NE QYTET DHE SHKOLLA	0.00	0.00	-	#DIV/0!
47962	47962 RREULLIMI I VARRZAVE TE MARRIVEVE	10,863.96	5,671.96	5,192.00	52.21
47976	47976 NDERTIMI I URAVE DHE MURREVE MBROJTËSE	3,600.49	3,600.49	-	100.00
48102	48102 NDERTIMI I SHESHIT "AHMET KRASNIQI"	14,674.50	9,681.50	4,993.00	65.97
49579	49579 RREGULLIMI I HAPËSRAVE PUBLIKE -SHESHEVE	25,000.00	25,000.00	-	100.00
50988	50988 NDERTIMI I RRUGEVE "PANDELI SOTIRI"	20,100.00	16,737.25	3,362.75	83.27
50991	50991 RREGULLIMI I SHITRATIT TE LUMIT SILNICA-PJESA E QYTETIT	152,000.00	152,000.00	-	100.00
51020	51020 RREGULLIMI I RRUGEVE ,,GALIP BADIJKU"	45,200.00	39,148.30	6,051.70	86.61
51202	51202 RINDERTIMI I RRUGEVE ME INFRASTRUKTURE	130,000.00	128,874.18	1,125.82	99.13
51202	51202 RINDERTIMI I RRUGEVE ME INFRASTRUKTURE	25,000.00	24,999.09	0.91	100.00
92060	92060 NGRITJA E PERFORMANCES 2019	3,985.65	0.00	3,985.65	-
92111	92111 PERFORMANCA KOMUNALE 2021	284,854.00	278,568.27	6,285.73	97.79
93196	93196 NDERTI PIK PRITESE PER AUTOB-PRI-ZHI-BIV-STR	906.20	0.00	906.20	-
TOTALI		1,927,819.94	1,582,105.56	346,714.38	82.07
470	ZJRRIFKISIT	2,000.00	-	2,000.00	-
50962	POMPA TRITHESE	2,000.00	-	2,000.00	-
TOTALI		2,000.00	-	2,000.00	-
470	BUGJESI PËLLARI DHE ZHVILLIM RURAL	991.00	0.00	991.00	-
48182	48182 NGRITJA E PEMSHITEVE	991.00	0.00	991.00	-
49561	49561 PROJEKTI NE BASHKEFINANCIM ME DONATORE	270,000.00	182,638.10	87,361.90	67.64
51203	51203 NDERTIMI I KANALEVE KULLESE NE LUMADH DHE DUMNICE E ULLET	51,000.00	13,192.74	37,807.26	25.87
51204	51204 RR I SHTR TE LUNE NE STUDIME MAXHUNAJ DHE DUMNICE E MESME	89,000.00	16,564.00	66,436.00	19.96
72675	72675 FURNIZIM ME PAJISE PER BLETARI	9,600.00	9,600.00	-	100.00
72691	72691 FURNIZIM ME MAKINA PER SHKOKULMIN E MISRI	1,800.00	0.00	1,800.00	-
90231	90231 RREGULLIMI I LUMENIVE DHE ARGJINATURAVE	113,860.56	73,094.00	40,766.58	64.20
TOTALI		530,251.58	295,088.84	235,162.74	55.65
660	PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	646,874.00	646,874.00	161,998.10	83.94
41424	41424 NDERTI RRUGO LOKALE NE FSHATRA	1,008,872.30	646,874.00	161,998.10	83.94
45265	45265 ASFALTIMI I RRUGEVE NE QYTET	87,050.56	1,100.00	86,950.56	1.26
45366	45366 ASFALTIMI I RRUGEVE SLLAKOC -KURILLOVE	100,000.00	0.00	100,000.00	-
45632	45632 ASFALTIMI I RRUGEVE VUSHTRRI- MADAKOC-PESTOVE	103,889.44	74,882.60	29,006.84	72.08
49579	49579 RREGULLIMI I HAPËSRAVE PUBLIKE -SHESHEVE	93,070.65	27,518.08	5,552.67	83.21
49585	49585 NDERTIMI I KIOSJEVER NE SHESHIN "ADEM JASHARI"	3,682.00	3,682.00	0.00	100.00
49586	49586 MBJELLJA E DRUNJVE DEKORATIVE	25,000.00	13,517.04	11,482.96	54.07
50965	50965 ASFALTIMI I RRUGEVE SAMADREKHE -DUMNICE	4,000.00	0.00	4,000.00	-
50969	50969 ASFALTIMI I RRUGEVE NE FSHATIN SKOZEN	4,000.00	0.00	4,000.00	-
86183	86183 ASFALTIMI I RRUJVE DEZHMORET E KOMBIT	15,000.00	0.00	15,000.00	-
96018	96018 SHETITJE NE HISTORI	14,775.26	14,775.26	0.00	100.00

TOTALI	1,399,340.23	982,348.98	416,991.25	70.20
--------	--------------	------------	------------	-------

KUDJESI PRIMAR SHENDETESOR			
730	41427 NDERTIMI I QMF NE VUSHTRRI	78,000.00	12,874.16
	42523 PAJISE MJEKESORE	110,927.00	85,927.00
	45261 FURNIZIM ME INVENTAR	7,813.38	7,813.38
	48280 RREGULLIMI I OBORREVE DHE HAPESIRAVE TE QMF-VE DHE AMF-VE	47,000.00	16,410.77
	45877 NDERTIMI I KENDEVE TE VAKSINIMIT	15,000.00	0.00
	51205 VENDOSJA E RRETHOJAVE NE OKMF VUSHTRRI	30,000.00	30,000.00
	TOTALI	288,740.38	84,284.93
			204,466.46
			29.19
SHERBIMEET SOCIALE REZIDENCIALE			
755	49628 RENOVIMI I QENDRES PER KUJDES DITOR PER TE MOSHUAR	50,000.00	50,000.00
	50984 RENOVIMI I QENDRES REZIDENCIALE	10,000.00	1,157.75
	TOTALI	60,000.00	1,157.75
			58,842.25
			1.93
KULTURE, RINI, SPORT			
850	48019 LIBRA PER BIBLIOTEKE	5,000.00	4,888.00
	46835 PAJISE PER MUZEUM-ZRYREN E TURIZMIT	3,196.50	3,196.50
	46840 RENOVIMI I STADIUMIT TE HENDBOLLIT "MUSA ABAZI"	60,000.00	60,000.00
	48265 PLLAKAT PER KUTIMORE	1,132.50	1,132.50
	48275 RENOVIMI I PALESTRIS SPORTIVE DHE RRETHOJES	2,418.00	2,418.00
	48294 QENDRA INOVATIVE "VICIANKA"	10,000.00	0.00
	48361 NDERTIMI I FUSHES NDIMKESSE TE STADIUMI I FUTBOLLIT (FAZA II)	65,000.00	10,332.90
	49580 INVENTARIZIMI I QENDRES SE KULTURES	20,000.00	19,620.00
	50985 PARKU REKREACIONAL PER RINJTE "TARAKHA"	2,000.00	2,000.00
	51007 RENOVIMI I PALESTRIS "JETON TERRASTENA"	20,000.00	20,000.00
	TOTALI	188,747.00	43,840.90
			144,906.10
			23.23
ARSIM DHE SHKENCE			
920	41440 NDERTIMI I RRETHOJAVE NE SHKOLLA	40,000.00	25,903.12
	43946 Inventar per shkolle	41,359.00	21,504.00
	46575 TEKNOLOGJI INFORMATIVE	60,000.00	60,000.00
	46587 FUSHA SPORTIVE	45,000.00	30,000.00
	47970 SALLA SPORTIVE	50,000.00	25,158.03
	49551 DEPO PER SHKOLLA	5,000.00	0.00
	49565 PAJISE LABORATORIKE DHE MJETE KONKRETIZIMI	50,000.00	8,000.00
	49573 RENOVIMI I NGROHJEVE QENDRORE	30,000.00	22,567.58
	50987 KUZHINA PER QERDHET E REJA	20,000.00	18,110.05
	51008 NDERTIMI I TOLETEVE NE SHKOLLA	25,000.00	19,991.44
	90282 MEREMETIMI I SHKOLLAVE	125,000.00	123,042.79
	47909 NDERTIMI I QERDHES SE RE	78,228.00	38,670.40
	42142 BASHKEFINANCIIMI I INVESTIMEVE KAPTUALE	5,483.00	5,280.00
	49533 NDERTIMI I ANEKSIT NE SH.F. "ANTON ZAKO ÇAJUPI"	5,000.00	0.00
	46561 NDCRTIMI I PUNTORISE DHE KABINETEVE NE SHKOLLEN TEKNIKE	32,091.13	13,930.42
	51030 MAKINA DHE PAJISE PER MESIM PRAKTIK NE SHKOLLE "LUTFI MUSIQI"	5,000.00	0.00
	51032 KLIMA NE GJIMNAZIN "EGREBIM ÇABELI"	25,000.00	21,315.56
	93222 RREGULLIMI I SHKOLLES BAHRI HAKHA	577.05	0.00
	95104 FURNIZ MJETE PER PUNTOR SALDATOR-AKHUSTATORREVE	157.00	0.00
	TOTALI	642,905.18	432,853.31
			210,051.87
			67.33
SUBTOTALI			
		5,069,044.31	3,438,148.13
			1,630,896.18
			67.83



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI

**DRAFT - PLANI
I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR
VITIN 2022**

Janar, 2022

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
Qëllimi.....	5
Janar.....	6
Shkurt.....	7
Mars	8
Prill.....	9
Maj	11
Qershor	12
Korrik.....	13
Gusht.....	14
Shtator.....	15
Tetor	16
Nëntor.....	17
Dhjetor	18

HYRJE

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët, si dhe funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL), Statutit të Komunës dhe akteve tjera nënligjore.

Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe rregulloren e punës, rregulloret komunale, miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;
- planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij ligji;
- zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës;
- nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike;
- arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brendakomunale;
- marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës;
- përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij Komitetit për Politikë dhe Financa apo Kryetarit të komunës. Kuvendi i komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, Planin vjetor të prokurimit, Rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, Planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, për marrjen e raporteve nga kryetari, si dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e komunës.

Kuvendi i komunës siguron kushte të punës për mbajtje të mbledhjeve të Kuvendit të komunës, krijon hapësirë për pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë mbledhjeve, siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i komunës kryen edhe aktivitete tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësisë së tij, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të padeleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e komunës;
- Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK);
- Miratimin e Planeve Strategjike të Zhvillimit Ekonomik Lokal etj.

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren për Punën e Kuvendit dhe Organeve të Tij dhe akteve tjera nënligjore. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike, i cili planifikon etapa të realizimit të punëve dhe detyrave të kuvendit, të bazuara në përgjegjësitë që dalin nga legjislacioni në fuqi.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2022, ku Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë planifikon t'i mbajë njëmbëdhjetë (11) mbledhje të rregullta, gjashtë prej të cilave në gjashtëmuorin e parë të vitit 2022, në të cilat do të trajtohen çështjet që janë në interes të komunës dhe të qytetarëve të saj. Përveç tjerash, kuvendi i komunës trajton edhe këto çështje:

- Miraton buxhetin, planet investuese, planin vjetor të prokurimit;
- Miraton çështjet tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin, sipas statutit apo rregullores së punës;
- Nxjerr rregullore dhe bën harmonizimin e rregulloreve ekzistuese, sipas ligjeve në fuqi;
- Themelon komitetet këshillëdhënëse dhe trupa tjera ad-hoc sipas nevojës;
- Planifikon shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së Kryetarit të komunës sipas ligjit;
- Organizon takime buxhetore me qytetarë, lidhur me planifikimin e buxhetit të komunës;
- Mbikëqyr, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit komunal.

QËLLIMI

Plani vjetor i punës i Kuvendit të komunës ka për qëllim që t'i ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të kuvendit këtë plan, në ç' rast ata do ta kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2022, e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me këtë plan janë paraparë njëmbëdhjetë (11) mbledhje të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe mbledhje të tjera, përfshirë mbledhjet e jashtëzakonshme, urgjente, solemne, siç parashihen me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, Udhëzimin Administrativ për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Dinamika e Planit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë do të realizohet në bazë të orarit të mbledhjeve të kuvendit, të miratuara në mbledhjen e parë të kuvendit në vitin 2022.

Kryesuesja e kuvendit mund të mbajë takime mujore ose sipas nevojës me shefat e grupeve kuvendare të subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend, me qëllim të bashkërendimit të punës së kuvendit.

Për përmbushjen e planit të punës, ekzekutivi iu ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës, sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të të gjitha aktiviteteve sipas dinamikës, të përcaktuara me këtë plan do të përkujdesen: Kryetari i komunës, Kryesuesi i kuvendit dhe Sekretaria e kuvendit.

Realizimi i Planit të punës të kuvendit, kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me ekzekutivin e komunës, i cili duhet t'i përmbahet Planit të kuvendit për vitin 2022.

Plani i punës i kuvendit sipas dinamikës mujore përfshin: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga kuvendi.

**PLANI
I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR VITIN 2022**

JANAR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	10.01.2022
2.	Draft-plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2022	Kryesuesja e Kuvendit dhe Sekretaria e Kuvendit		10.01.2022
3.	Draft-plani i Punës i Kryetarit të Komunës për 2022	Kryetari i Komunës		10.01.2022
4.	Propozim-vendimi për themelimin e Komitetit për Komunitete	Zyra e Kryetarit të Komunës		10.01.2022
5.	Propozim-vendimi për themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi	Zyra e Kryetarit të Komunës		
6.	Të ndryshme			10.01.2022

SHKURT

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Propozim-vendim për ndarjen e subvencioneve	Kryetari i komunës	Komisioni vlerësues për ndarje të subvencioneve	03.02.2022
2.	Rishikimi i Planit të Veprimit për të gjeturat e Auditorit	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		03.02.2022
3.	Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2020 në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale		03.02.2022
4.	Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2020	Komandanti i stacionit policor në Vushtrri		03.02.2022
5.	Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020	Kryetari i komunës		03.02.2022
6.	Plani pesëvjeçar i menaxhimit të mbeturinave 2022-2026	Drejtoria e Shërbimeve Publike		03.02.2022
7.	Të ndryshme			03.02.2022

MARS

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2022	Kryetari i komunës		04.03.2022
2.	Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022	Drejtorja për Buxhet dhe Financa		04.03.2022
3.	Propozim-vendim për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblime për nxënës	Drejtorja për Arsim		04.03.2022
4.	Informatë për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2021/2022	Drejtorja për Arsim		04.03.2022
5.	Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Organeve të Tij	Kryesuesja e Kuvendit		04.03.2022
6.	Të ndryshme			04.03.2022

PRILL

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	07.03.2022
2.	Informatë lidhur me ndërtimin në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Inspektime		07.03.2022
3.	Informatë tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore	Drejtoria për Inspektime		07.03.2022
4.	Informatë lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë		07.03.2022
5.	Raport i Komisionit të Aksionarëve për punën njëvjeçare të Ndërmarrjes regjionale për menaxhimin e mbeturinave “Uniteti”	Drejtoria për Shërbime Publike, Komisioni i Aksionarëve		07.03.2022
6.	Raport i punës njëvjeçare i Ndërmarrjes regjionale ujësjellësi “Mitrovica”	Drejtoria për Shërbime Publike		07.03.2022
7.	Të ndryshme			07.03.2022

MAJ

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Propozim- vendim për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Komisioni për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave	02.05.2022
2.	Informatë lidhur me Qarkoren buxhetore 2022 dhe miratimi i Planit të veprimit për dëgjimet publike	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		02.05.2022
3.	Informatë lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural		02.05.2022
4.	Informatë për përfundimin e periudhës së dytë të vitit shkollor 2021-2022	Drejtoria e Arsimit		02.05.2022
5.	Të ndryshme			02.05.2022

QERSHOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Draft Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2023-2025	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		03.06.2022
2.	Informatë për shfrytëzimin e pasurisë së komunës	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	03.06.2022
3.	Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë	Drejtoria për Administratë		03.06.2022
4.	Informatë rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		03.06.2022
5.	Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2021/2022	Drejtoria për Arsim		03.06.2022
6.	Të ndryshme			03.06.2022

KORRIK

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Informatë lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar-qershor 2022	Kryetari i komunës		01.07.2022
2.	Raport gjashtëmuor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	01.07.2022
3.	Informatë tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore	Drejtoria për Inspektive		01.07.2022
4.	Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2022	Komandanti i stacionit policor		01.07.2022
5.	Pasqyrat financiare për vitin 2022 dhe raporti i auditorit	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	01.07.2022
6.	Të ndryshme			01.07.2022

GUSHT

MUAJ I PUSHIMEVE

SHTATOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2023	Kryetari i komunës		02.09.2022
2.	Vendim për caktimin e normave tatimore për vitin 2023	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		02.09.2022
3.	Raporti i sistemit për matjen e performancës në ofrimin e shërbimeve komunale	Koordinatori për performancë i Komunës së Vushtrrisë		02.09.2022
4.	Raport për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershor 2022	Kryetari i komunës		02.09.2022
5.	Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		02.09.2022
6.	Informatë për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural		02.09.2022
7.	Rishikimi i Planit të Veprimit për të gjeturat e Auditorit	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		02.09.2022
8.	Informatë lidhur me zbatimin e Strategjisë Zhvillimore të Komunës	Kryetari i komunës	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	02.09.2022
9.	Të ndryshme			02.09.2022

TETOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	03.10.2022
2.	Informatë lidhur me zbatimin e Hartës zonale komunale	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		03.10.2022
3.	Informatë për furnizimin me ujë të pijes në territorin e Komunës së Vushtrrisë	Drejtoria për Shërbime Publike		03.10.2022
4.	Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2022/2023	Drejtoria për Arsim		03.10.2022
5.	Informatë nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport		03.10.2022
6.	Të ndryshme			03.10.2022

NËNTOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Informatë lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural		02.11.2022
2.	Informatë lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		02.11.2022
3.	Informatë tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore	Drejtoria për Inspektive		02.11.2022
4.	Informatë për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë	Drejtoria për Shërbime Publike		02.11.2022
5.	Të ndryshme			02.11.2022

DHJETOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Informatë për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale		02.12.2022
2.	Draft-plani i Punës të Kryetarit të Komunës për 2023	Kryetari i komunës		02.12.2022
3.	Draft-Plani i Punës i Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2023	Kryesuesja e kuvendit		02.12.2022
4.	Të ndryshme			02.12.2022

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



PLANI I PUNËS PËR VITIN 2022

Janar, 2022

Hyrje

Kryetari i komunës i ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e tij që janë me interes për komunën dhe qytetarët, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës, vendimet e Kuvendit të komunës dhe aktet tjera nënligjore. Këto kompetenca dhe përgjegjësi realizohen po ashtu edhe në bazë të planit të tij të punës, i cili është dokument bazë për punën njëvjeçare të kryetarit të komunës, përkatësisht qeverisë komunale.

Hartimi i këtij plani është një reflektim i angazhimit të vazhdueshëm për t'i kanalizuar nismat për planifikim të objektivave dhe prioriteteve, të cilat do të mund të realizohen bazuar në planifikimin buxhetor të v. 2022, për t'ju ofruar shërbime sa më cilësore qytetarëve dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët tanë pa dallim. Natyrisht se gjatë përmbushjes së këtyre objektivave ka sfida dhe vështirësi, të cilat mund të paraqiten gjatë punës sonë, por me një angazhim të përbashkët dhe përkushtim mund të arrihen rezultate të dëshirueshme.

Ky plan i punës paraqet prioritetet e Kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2022, si dhe jep përmbledhje të objektivave, aktiviteteve të planifikuara dhe realizimin e atyre objektivave, respektivisht aktiviteteve. Po ashtu, përcakton edhe treguesit, si dhe afatet kohore për kryerjen e secilit prej aktiviteteve dhe objektivave të parapara, por i cili përgjatë vitit 2022 do të mund të evoluojë varësisht prej nevojave e kërkesave të qytetarëve.

Objektivat kryesore:

1. Zhvillimi ekonomik

- Lirimi nga pagesa për bizneset e gastronomisë që shfrytëzojnë hapësirat publike për vendosjen e tarracave;
- Rritja e fondeve për subvencionime në bujqësi;
- Mbështetja e bizneseve prodhuese, duke ua mbuluar normën e interesit të kredive në vlerë deri 20,000 euro;
- Hapja e zyrës për diasporë dhe promovim të klimës së investimeve;
- Ofrimi i lehtësirave administrative për investitorët e diasporës;
- Bashkëpunimi me diasporën në përgatitjen e kuadrove tona në vendet perëndimore, në fushën e të bërit biznes.

2. Rinia, kultura, avancimi i gruas dhe sporti

- Fezivali i Poezisë;
- Ditët e Hasan Prishtinës;
- Ditët e Diasporës;

- Festivali i Patates;
- Ekspozita e piktorëve vushtrrias;
- Turniri në shah.

3. Arsimi:

Arsimi parauniversitar

- Edukimi në fëmijërinë e hershme dhe gjithëpërfshirja në arsim;
- Menaxhimi i sistemit arsimor;
- Mësimdhënia dhe zbatimi i kurrikulës së bazuar në kompetenca;
- Cilësia dhe llogaridhënia;
- Zhvillimi profesional i mësimdhënësve;
- Bashkëpunimi shkollë-prindër;
- Siguria në shkolla.

Arsimimi dhe aftësimi profesional

- Harmonizimi i profileve profesionale me kërkesat e tregut të punës;
- Lidhja e arsimit praktik në ndërmarrje.

Arsimi për të rritur

- Ofrimi pa pagesë i arsimit për të rritur për profilet e kërkuara në tregun e punës;
- Përgatitje e kuadrove për tregun e punës përmes sistemit modular;
- Mbështetja e hapjes së bizneseve;
- Bashkëpunimi me diasporën.

4. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale

- Riorganizimi dhe reformimi i sektorit të shëndetit oral;
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në shtëpi për persona të palëvizshëm.

4.1 Mirëqenia sociale

- Punësimi i një psikologu të licensuar;
- Përkujdesje për familjet pa strehë;
- Përkujdesje për të moshuarit.

5. Infrastruktura dhe mbrojtja e ambientit

- Përfundimi i infrastruktures rrugore, ujësjellësit nëpër të gjitha fshatrat;
- Ndriçimi i rrugëve në qytet dhe fshatra;
- Renovimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, objekteve të institucioneve;
- Ndërtimi i dy fushave të futbollit të vogël;

- Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit në palestrën e sporteve “Jeton Tërstena”, si dhe rregullimi i zhyeshitoreve;
- Renovimi i stadiumit të futbollit “Ferki Aliu”;
- Vendosja e pengesave profesionale në rrugët e rrezikuara;
- Orientimi i disa rrugëve njëkahore në qytet.

5.1 Mbrojtja e ambientit

- Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe djegiet;
- Mirëmbajtja e ambientit në qytet dhe fshatra;
- Mbjellja e 1000 drunjve dekorativ në qytet dhe oborre të shkollave;
- Mirëmbajtja e sipërfaqeve në varreza të qytetit dhe fshatra;
- Menaxhimi i mbeturinave;
- Pastrimi i rregullt i rrugëve në qytet;
- Hartimi i planit urban;
- Ruajtja e zonave nën komasacion nga ndërtimet ilegale;
- Ndalja e ndërtimeve ilegale;
- Ruajtja e vijës së ndërtimit sipas Ligjit të ndërtimit.

6. Administrata

Reformimi i administratës komunale përmes:

- Krijimit të kushteve për punë profesionale në administratë;
- Hartimit të Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
- Zhvillimit të vazhdueshëm profesional të zyrtarëve të administratës;
- Koordinimit institucional të të gjitha institucioneve me komunën;
- Administrimit të fshatrave përmes koordinimit me këshillat e fshatrave;
- Modernizimit të administratës.

7. Turizmi

- Promovimi i turizmit malor në Malet e Shalës dhe Qyqavicës;
- Rregullimi i infrastrukturës turistike në këto dy zona;
- Hartimi i një udhëzuesi turistik për objektet e trashëgimisë kulturore, Kalaja, Ura e Gurit dhe Hamami, Kulla e Azem Bejt Galicës, si dhe Malet e Shalës dhe Qyqavicës;
- Shfrytëzimi i objekteve kulturore, Kalaja dhe Kulla e Azem Bejtës për organizimin e festivaleve.

Prioritetet kryesore gjatë vitit 2022:

- Menaxhimi efektiv dhe transparent i buxhetit të komunës;

- Angazhimet e vazhdueshme për realizimin e të hyrave të planifikuara buxhetore dhe shfrytëzimi sa më racional i mjeteve buxhetore, përkatësisht shpenzimeve buxhetore, si dhe raportimi i rregullt në kuvendin e komunës;
- Implementimi sipas planifikimit i projekteve kapitale, si dhe angazhimi për shpenzim maksimal të mjeteve financiare të investimeve kapitale, sidomos mjeteve të grantit qeveritar;
- Ngritja e bashkëpunimit me organet e nivelit qendror, sidomos me Qeverinë e Republikës së Kosovës, në implementimin e projekteve të mëdha që janë me rëndësi dhe interes për komunën dhe qytetarët;
- Përcjellja e implementimit të kontratave për personat në pronësi të komunës e që janë dhënë në shfrytëzim qoftë afatshkurtër apo edhe ato afatgjatë (tokave dhe objekteve);
- Ndërmarrja e masave për lirimin e pronave komunale të uzurpuara;
- Angazhimet për gjetjen e donatorëve për investime kapitale në komunë e në veçanti në sektorin e bujqësisë;
- Rritja e prodhimitarisë bujqësore, përmirësimi i cilësisë së atyre prodhimeve, organizimi i trajnimeve dhe këshillimeve profesionale për fermerë, si dhe subvencionimi i tyre;
- Angazhimet për investime nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe për ndërtimin e argjinaturave buzë lumit „Silnica“ për mbrojtje të tokave bujqësore nga vërshimet, të cilat janë duke shkaktuar çdo vit dëme të konsiderueshme materiale në bujqësi;
- Angazhimet për kthimin në pronësi të komunës të parcelave që më herët iu ishin dhënë në shfrytëzim Burgut të Smrekonicës, të cilat tani evidentohen në emër të Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim të themelimit të zonës së lirë ekonomike në fsh. Banjskë dhe Smrekonicë.
- Menaxhim më i mirë i mbeturinave, duke marrë për bazë Planin për menaxhimin e mbeturinave;
- Ofrimi i shërbimeve administrative sa më cilësorë ndaj qytetarëve;
- Gjithpërfshirja në arsim dhe ngritja e cilësisë së punës në institucionet e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore;
- Avancimi i aktiviteteve kulturore atyre të rinisë dhe në lëmin e sportit;
- Ofrimi i mbështetjes së klubeve sportive, organizatave të dala nga lufta, organizatave rinore, OJQ –ve tjera të komunës, si dhe kategorive tjera;
- Bashkëpunimi me organet e nivelit qendror, veçanërisht me qeverinë dhe ministrinë e linjes në aspektin e zbatimit të ligjshmërisë, në rastin e marrjes së vendimeve me rëndësi dhe interes për komunën dhe qytetarët;
- Bashkëpunimi me organizatat vendore e ndërkombëtare;
- Bashkëpunimi me KFOR-in, Policinë e Kosovës, FSK-në, në aspektin e sigurisë së përgjithshme;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe qytetarë, duke krijuar mundësitë për pjesëmarrje të tyre në proceset e vendimmarrjes në komunë;
- Angazhime tjera për punë me interes për komunën dhe qytetarët që mund të paraqiten përgjatë vitit 2022.

Në vijim do të paraqiten planet e punës sipas fushave – drejtorive/sectorëve

BUXHETI DHE FINANCAT

Në përmbajtje të Planit të Punës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për vitin 2022, janë përfshirë:

- Disa objektiva si më thelbësore në mesin e shumë objektivave që ka kjo drejtori;
- Përshkrimin dhe konkretizimin e të gjitha detyrave dhe përgjegjësive në aspektin financiar sipas programeve buxhetore në nivel të komunës, dhe
- Përcaktimi i bartësve me afatet kohore për realizimin e detyrave sipas sektorëve funksional.

Objektivat

- Hartimi i Propozim buxhetit të komunës përmes një sistemi transparent, në pajtim me praktikat më të avancuara, si dhe me Qarkoret buxhetore të nxjerra nga MFPT
- Shtimi dhe rritja e aktiviteteve për vetëdijesimin e qytetarëve në përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë dhe obligimeve të tjera qytetare, duke respektuar legjislacionin tatimor, me qëllim të arritjes së planit të të hyrave vetanake;
- Menaxhimi financiar dhe i kontrollit, me qëllim të zbatimit në përpikëri me legjislaturën në fuqi;
- Krijimi i infrastrukturës për fillimin e procesit të regjistrimit të pasurisë komunale (tokë dhe ndërtesa), si dhe krijimin e regjistrit të shfrytëzuesve të pronave komunale;
- Realizimi i buxhetit (të hyrat dhe shpenzimet) do të kontrollohet përmes raporteve periodike që do të bëhen në Kuvendin komunal dhe në Ministrinë e Financave;
- Krijimi i serverit për menaxhimin e procesit të pranimit të faturave dhe lidhja e tij me SIMFK;
- Inkasimi i të hyrave vetanake;
- Raportimet në kuvend me focus të veçantë për pasqyrat periodike dhe vjetore financiare.

Spektori për buxhet dhe financa

Në Sektorin për buxhet dhe financa gjatë vitit 2022 do të punohet:

- Përgatitja e Planit të rrjedhës së parasë, respektivisht Planit për zotimin-shpenzimin e buxhetit të vitit 2022 për të gjitha programet buxhetore;
- Pasqyrat financiare vjetore deri më 31.12. 2021;
- Përgatitja e raportit perfundimtar janar-dhjetor e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore 2021;
- Bartja e mjeteve të mbetura të pashpenzuara nga viti 2021 (të hyrat vetanake) për shpenzim në vitin 2022;

- Raportimi i faturave të papaguara për të gjitha programet;
- Zotimi i mjeteve të alokuara për programe;
- Regjistrimi i shpenzimeve sipas modulit të aprovimit dhe blerjes;
- Menaxhimi i parasë së gatshme;
- Certifikimi dhe aprovimi i të gjitha pagesave në nivel komunal;
- Barazimet në baza mujore me MFPT dhe komunës;
- Barazimi mujor i shpenzimeve në sistemin SIMFK (free balance);
- Raportet tremujore të progresit të realizimit të projekteve kapitale;
- Rishikimi buxhetor 2022;
- Përcjellja e realizimit të shpenzimeve buxhetore të mjeteve sipas dinamikës së paraparë për vitin fiskal 2022;
- Përgatitja dhe azhurnimi i KAB-it komunal 2022-2024 dhe planifikimi i buxhetit për vitin 2023-2025 konform Qarkoreve buxhetore nga MFPT, si dhe udhëzimeve tjera;
- Regjistrimi i të dhënave buxhetore në sistemin BDMS (sistemi i zhvillimit dhe menaxhimit të buxhetit) dhe PIP (programi i investimeve publike);
- Ndhmon të gjitha programet komunale në regjistrimin e të dhënave në BDMS dhe PIP sistem;
- Siguron procedura dhe formate administrative për hartimin e buxhetit 2022-2024;
- Siguron material mbështetës për dëgjimet buxhetore për të gjithë pjesëmarrësit në proces;
- Hartimi i raporteve mujore dhe periodike financiare për vitin 2022;
- Barazimet periodike me Departamentin e Thesarit për të hyra dhe të dala;
- Mbajtja dhe azhurnimi i regjistrit të pasurive komunale;
- Regjistrimi në SIMFK i pasurisë me vlerë mbi 1.000 €;
- Regjistrimi në E-pasuri i të gjitha asetëve nën 1000 €;
- Përgatitjet dhe aktivitetet për përmbylljen e vitit fiskal buxhetor 2022;
- Raportet periodike dhe përfundimtare të buxhetit për Kuvendin komunal, raportet periodike të realizimit të projekteve kapitale dhe dorëzimi i tyre në MFPT.

Përveç planeve të cekura më sipër, Sektori i buxhetit dhe financave do të jetë në bashkëpunim permanent me MFPT, Departamentin e Buxhetit dhe Thesarit, për çdo ndryshim eventual me qëllim të ndryshimeve të granteve dhe përfitimeve të donacioneve të ndryshme stimuluese.

Të hyrat vetanake mblidhen nga vetë komuna duke u bazuar në Ligjin mbi Financat e Pushtetit Lokal dhe në rregulloret që rregullojnë fushën e të hyrave brenda komunës. Planifikimi dhe parashikimi i të hyrave vetanake është një çështje e rëndësishme e cila kërkon përpjekje për të arritur një pasqyrë reale dhe të suksesshme.

Sektori për buxhet dhe financa do të bëjë përpjekje për zhvillimin e kapaciteteve, të cilat do të përfshijnë modele të ndryshme dhe të dhëna të reja që do të çojnë në projeksione më të arsyeshme sa i përket planifikimit dhe parashikimit të të hyrave vetanake.

Përveç detyrave të cekura më sipër, stafi i Sektorit për buxhet dhe financa do të mbajë korrespondencë permanente me drejtoritë dhe me MFPT për çdo ndryshim eventual, me qëllim të rritjes së performancës së punës dhe respektimit të afatëve për realizimin e detyrave. Gjithashtu

me Departamentin e Thesarit do të mbajmë lidhje të përhershme me qëllim të realizimit të mjeteve buxhetore, e posaçërisht me ndryshimet eventuale që do të ndodhin brenda vitit.

Në kuadër të Sektorit për buxhet dhe financa - njësia e të hyrave vetanake gjatë vitit 2022 do të punojë edhe në:

- Planifikimin e të hyrave sipas llojeve dhe programeve përbrenda komunës dhe harmonizimin e tyre sipas pozicioneve brenda kufijve të buxhetit të planifikuar – miratuar;
- Raportet mujore për arkëtimin e të gjitha të hyrave komunale sipas llojeve dhe programeve;
- Arkëtimet ditore të të hyrave nga taksat dhe tarifrat, për shërbimet e ofruara nga komuna;
- Regjistrimin ditor të të hyrave në SIMFK (free-balance), sistem i MFPT, si dhe nxjerrja e raporteve të nevojshme bankare që pasqyrojnë të hyrat e arkëtuara;
- Barazimet për cdo muaj me drejtoritë komunale, si dhe Departamentin e Thesarit në Ministrinë e Financave;
- Shpërndarjen- alokimin për cdo muaj të të hyrave të realizuara sipas pozicioneve buxhetore të planifikuara;
- Inspektimet, evidentimin dhe regjistrimin e burimeve të reja të të hyrave.

Sektorin e tatimit në pronë

Parashihet lëshimi i afro **21000** faturave tatimore aktive (në shume prej **863,204.9€**), si dhe fillimi i ngarkesës për tatim në pronën bujqësore në një shumë të përgjithshme të planifikuar prej **196,852.3€**, e cila shumë për çdo vit kalendarik rritet për 20%, ku në vitin 2022 është 80% e shumës së caktuar sipas Ligjit të Tatimit në Pronë (shpërndarja e tyre deri tek obliguesit tatimorë do të bëhet në periudhën janar-mars).

Për periudhën prill-maj komisioni i ankesave administrative të TP-së, i cili merr vendime për ankesa, të cilat bëhen nga ana e obliguesve tatimorë, do të bëhen edhe ndryshime me kohë në programin e TP-së me vendimet e komisionit të ankesave.

Lëshuarja e certifikatave mbi objektet e patundshmërisë për Qendrën për punë sociale.

Do të bëhert shpërndarja e vërejtjeve dhe hulumtimi i llogarive bankare te tatimpaguesit, si dhe do të merret veprim i menjëhershëm për arkëtim të detyrueshëm, duke përfshirë bllokimin e llogarive bankare bazuar në Ligjin për Pronën e Paluajtshme.

Zbatimi i kushtëzimit në kryerjen e shërbimeve komunale për mospagesën e tatimit në pronë.

Gjatë këtij viti, parashihet që të regjistrohen afërsisht **4500** objekte të reja dhe 20% verifikime të pronave ekzistuese sipas ligjit, por presim që të tejkalojmë këtë përqindje.

Verifikimi i përmbushjes së obligimeve të stafit të komunës dhe informimi për mospagesë të tatimit në pronë, si të personave fizik ashtu edhe juridik në 19 zonat tatimore të aplikuara sipas vlerësimit nga DTP në bashkëpunim me Sektorin e tatimit në pronë.

EKONOMI, BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Nr	Prioritetet	Aktivitetet e planifikuara	Koha e implementimit	Buxheti €	Akterët implementues të projektit
1	Regjistrimi i bizneseve në kuadër të ARBK- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Shqyrtimi i kërkesave për aplikim për regjistrim të bizneseve, procedimi në ministrinë gjegjëse, shpërndarja e certifikatave. Shqyrtimi i kërkesave për ndryshime në certifikatë të biznesit, procedimi i lëndës në ministrinë gjegjëse, njoftimi i palës për ndryshime dhe aprovime. Shqyrtimi i kërkesave për shuarje të biznesit, procedimi i lëndës në ministrinë gjegjëse, njoftimi i palës për miratim.	Janar-dhjetor		QKB
2	Hartimi i propozim - vendimeve, shqyrtimi dhe përgjigjja në kërkesa, hartimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit etj.	Hartimi i të gjithave akteve dhe vendimeve në kohë të duhur. Shqyrtimi dhe përgjigjja e të gjitha kërkesave në afat brenda kornizave ligjore. Përfaqësimi në institucione shtetërore (grykëta, ministri).	Janar-dhjetor	-	Kryetari i komunës, Drejtoria e EBPZHR
3	Përgatitja e projekteve-paramasave	Hartimi i propozim projekteve-paramasave, shpalljeve me të gjitha aktet përcjellëse	Janar-qershor	-	Drejtoria e EBPZHR
4	Shërbime për fermerë	Regjistrimi dhe ndryshimet eventuale të fermerëve në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të fermave në EFR. Aplikimi i fermerëve për subvencione të shpallura nga MBPZHR, digjitalizimi me ELPIS, pranimi i	Janar-dhjetor	-	Drejtoria e EBPZHR

		dokumentacionit, dorëzimi në AZHB. Angazhimi në Programin e shërbimeve këshillimore të MBPZHR për fermerë, organizimi dhe mbajtja e trajnimeve për fermerë.			
5	Ngritja e komisioneve, hartimi i raporteve për nevoja të komunës dhe MBPZHR	Planifikimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore-raportimi. Formimi i komisionit për procesin e korrjes së drithrave, përcjellja e procesit – raportimi.	Janar - dhjetor	-	Kryetari i komunës, Drejtorja e EBPZHR
6	Bashkëpunimi me OJQ dhe akterë tjerë	Vazhdimi i bashkëpunimit me OJQ-të me të cilat jemi duke bashkëpunuar	Janar-dhjetor	-	Kryetari i komunës, Drejtorja e EBPZHR
7	Mbrojtja dhe menaxhimi i pyjeve	Mbulimi i terreneve me roje adekuate të pyllit (6 terrene), Damkosja e drunjve të prerë. Kontrollime permanente të terreneve. Regjistrimet e rregullta dhe të veçanta të terreneve. Pastrimi i pyjeve dhe mbikëqyrja e pastrimit. Mbrojtja nga prerjet ilegale dhe zjarret. Kontrolle në vendshitje me asistim të organeve të rendit-konfiskimet.	Janar-dhjetor		

PJESA FINANCIARE E PROJEKTEVE TË PLANIFIKUARA PËR VITIN 2022

Nr.	Lloji i investimit	Vlera e planifikuar (65%)	Participimi i fermerëve (35%)	Totali i investimit
1.	Furnizimi i fermerëve me serra	35,000.00	12,500.00	47,500.00
2.	Furnizimi i fermerëve me makina mbjellëse të grurit	30,000.00	10,500.00	40,500.00
3.	Furnizimi i fermerëve me makina mbjellëse të misrit	30,000.00	10,500.00	40,500.00

4.	Furnizimi i fermerëve me fidane të pemëve	20,000.00	7,000.00	27,000.00
5.	Furnizimi i fermerëve me freza për traktor (45%)	30,000.00	13,500.00	43,500.00
6.	Furnizimi i fermerëve me makina për zhveshjen e misrit	30,000.00	10,500.00	40,500.00
7.	Furnizimi i fermerëve me makina për shpërndarjen e plehut organik	30,000.00	10,500.00	40,500.00
8.	Subvencionimi i procesit të ujitjes	39,000.00	21,000.00	60,000.00
9.	Fondi për bashkëfinancim	160,000.00		160,000.00
	Gjithsej	404,000.00	96,000.00	500,000.00

PROKURIMI PUBLIK

Me këtë plan identifikohen në detaje të gjitha planifikimet e aktiviteteve të prokurimit që Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë planifikon t'i realizojë gjatë vitit fiskal 2022, për gjitha kategoritë e shpenzimeve, për mallra, shërbime dhe punë.

Meqenëse planifikimi i prokurimeve është ngusht i lidhur me përgatitjen e buxhetit komunal për vitin fiskal 2022, si dhe me aktivitetin, gjegjësisht planin e punës të drejtorisë, planifikimi i prokurimeve, në përgjithësi, do duhej të jetë i harmonizuar dhe të korrespondojë me kufijtë e buxhetit të Autoritetit kontraktues për vitin fiskal 2022, për të gjitha shtyllat e buxhetit, si vijon:

- Administratë (përfshirë gjitha drejtoritë komunale),
- Shëndetësi,
- Arsim,
- Zyra lokale e komuniteteve,
- Njësia e zjarrfikësve,
- Shtëpia rezidenciale në Lumadh.

Planifikimi përfundimtar për vitin 2022, si dokument i aprovuar nga organi kompetent i Autoritetit kontraktues (Kuvendi i Komunës), është pjesë përbërëse e Planit të punës të Drejtorisë për Prokurim Publik për vitin kalendarik 2022. Duke qenë se qeverisja e kaluar komunale nuk ka arrit ta aprovojë planifikimin e prokurimeve të A.K., për vitin 2022, ndërsa qeverisja e re, e dalë nga zgjedhjet e reja të 2021-it, pritet që në ditët në vijim ta hartojë dhe aprovojë në organin kompetent komunal panifikimin e prokurimeve të A.K., për vitin fiskal 2022. Planifikimi i prokurimeve i A.K., për vitin fiskal 2022, në të cilin do të pasqyrohen objektivat e drejtorive komunale dhe organeve tjera për realizim të projekteve sipas kategorive: punë, furnizime, shërbime, do të jenë objektivat kryesore të Drejtorisë për Prokurim Publik për vitin 2022, të cilat drejtoria, në

bashkëpunim të ngushtë me bartësit e drejtorive tjera komunale si Njësi shpenzuese të A.K., do t'i trajtojë, procedojë dhe realizojë në vitin fiskal 2022, konform ligjeve në fuqi.

Drejtoria për Prokurim siguron se të gjitha iniciimet e procedurave të aktivitetit të prokurimit do të zbatohen dhe kryhen sipas LPP-së, në afat të caktuar kohor, duke siguruar konkurrencë të drejtë, shfrytëzim sa më të mirë të parasë publike, efikasitet dhe ekonomizim në zbatimin e drejtë të procedurave të prokurimit, trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomik.

Secili proces i prokurimit do të administrohet përmes 8 hapave, si në vijim:

Hapi 1	Planifikimi i prokurimit
Hapi 2	Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës
Hapi 3	Përcaktimi i vlerës së prokurimit
Hapi 4	Përgatitja e dosjes së tenderit
Hapi 5	Publikimi
Hapi 6	Hapja dhe vlerësimi i tenderëve
Hapi 7	Dhënia dhe nënshkrimi i kontratës
Hapi 8	Menaxhimi i kontratave që përfshin hartimin e dokumentacionit përcjellës, dërgimi dhe publikimi në procedurë të paraparë ligjore përmes Platformës së E-prokurimi-t, të emëruarit për menaxhim të kontratës, mbkëqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, komisionin e pranimit teknik, komisionin e pranimit të mallrave dhe / ose shërbimeve dhe dokumente tjera.

Edhe gjatë viti fiskal 2022 detyrë parësore e drejtorisë do të jetë ulja e kostos së shpenzimeve për gjitha llojet e shpenzimeve, realizimi me kohë dhe në mënyrë cilësore i gjitha kërkesave të Njësite Shpenzuese të A.K., si dhe identifikimi real dhe vlerësimi i nevojave, në bashkëpunim të ndërsjellë me shfrytëzuesit e gjitha shtyllave të buxhetit, si dhe përgatitja e planifikimit preliminar për gjitha llojet e prokurimeve për vitin e ardhshëm fiskal.

Drejtoria për Prokurim për vitin 2022, parasheh trajnimin e personelit.

Një bashkëpunim të ngushtë drejtoria do ta ketë me AQP-në për të ofruar informata të nevojshme për të, kur AQP-ja në planin e saj ka udhëheqjen e prokurimeve të centralizuara për nevoja të autoriteteve kontraktuese të nivelit lokal ose atij qendror, ashtu sikurse është rregulluar me dispozitat e LPP-së. Drejtoria do të bashkëpunojë ngusht edhe me USAID-in dhe organizatat e caktuara joqeveritare mbi bazën e Marrëveshjes së bashkëpunimit e lidhur mes Komunës së Vushtrrisë dhe USAID-it, e cila në fokus ka bashkëpunimin, ofrimin e ndihmës dhe monitorimin e aktiviteteve të punës në Komunën e Vushtrrisë, me theks të veçantë trajnimin e stafit.

ARSIMI

Sistemi arsimor parauniversitar do të zhvillojë kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike, që përmes realizimit cilësor të kompetencave të jenë të gatshëm të krijojnë zhvillim të qëndrueshëm.

Vizioni

Arsim cilësor, gjithpërfshirje që siguron progres në zhvillimin ekonomik të vendit, duke krijuar kushte të përshtatshme për të zhvilluar mësimnxënie dhe mësimdhënie bashkëkohore.

Drejtoria e Arsimit duke ndjekur objektivat e hartuara në koordinim me politikat e MASHT-it, si dhe Planin Zhvillimor Komunal të Arsimit, ka nxjerrë prioritetet kryesore në të cilat mbështetet plani i punës i DA-së, e të cilat janë:

- Mjedis shkollor i përshtatshëm për mësimdhënie dhe mësimnxënie efektive,
- Organizimi dhe mbajta e garave të ndryshme,
- Mbikëqyrje dhe monitorim i vazhdueshëm në të gjitha institucionet e nivelit parauniversitar, lidhur më përkrahjen dhe rritjen e përgjegjësisë,
- Sigurimi, zhvillimi i cilësisë dhe zbatimi i KK-së,
- Bashkëpunimi dhe ndërveprimi me të gjitha palët në interes të zhvillimit të arsimit.

Nr.	Objektivat	Aktivitetet	Financuar në euro	Afati	Bartësit e aktiviteve	Ndërlidhja me aktet tjera
1.	Mjedis shkollor i përshtatshëm për mësimdhënie dhe mësimnxënie efektive	Pajisje më inventar për shkolla	85,796.00	Janar-dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
		Pajisje me kompjuter	118,831.00	Janar-dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
		Pajisje me makina fotokopjuese	6,200.00	Janar-dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
		Pajisje tjera: makinë kositëse	52,725.00	Janar-dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit,	PZHKA

	projektor, mbajtëse të projektorëve, hidrofor)			Drejtoria për Buxhet dhe Financa	
	Blerja e librave dhe veprave artistike	2,900.00	Janar-dhjetor	DA Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
	Furnizim për zyrë (material didaktik, tepih, perde)	79,235.00	Janar-dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
	Furnizim me ushqim dhe pije (ushqim, pije për çerdhe dhe shujta për nxënës nga klasa 1-5)	209,571.00	Janar-dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa	PZHKA
	Furnizim me material higjienik	45,641.00	Janar-dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
	Furnizim më lëndë djegëse	150,658.00	Janar-dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
	Mirëmbajtje dhe meremetim i shkollave	150,919.00		DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
	Mirëmbajta e IT.	5,956.00	Janar-dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
	Mirëmbajtje e mobilieve dhe pajisjeve	4,067.00	Janar-dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit,	PZHKA

			Drejtoria për Buxhet	
Qiraja për pajisje (fotokopje)	10,037.00	Janar-dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
Subvencione (bursat, transporti i nxënësve, përkrahja e nxënësve në arritje të larta)	60,000.00	Janar-dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa	PZHKA
Renovim të ngrohjes qendrore	20,000.00		DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
Ndërtimi i tualeteve	40,000.00	Janar - dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
Ndërtimi i platove më kubëza betoni	30,000.00	Janar - dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
Ndërtimi i çerdhes së re-faza e parë	20,000.00	Janar - dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
Klima për çerdhe dhe për shkollë të muzikës	10,000.00	Janar - dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
Ndërtimi i rrethojave	40,000.00	Janar - dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA

	Ndërtimi i fushës sportive	50,000.00	Janar - dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit Drejtoria për Buxhet	PZHKA
	Depo për shkolla	5,000.00	Janar - dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
	Ndërtimi i aneksit në SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri	20,000.00	Janar - dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
	Pajisje për praktikë profesionale	57,000.00	Janar - dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet	PZHKA
	Përfshirja e gjithë nxënësve në arsim	Pa kosto	Janar - dhjetor	Zyrtarët e DA-së MASHTI	
	Funksionimi i ekipit për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore	Pa kosto	Janar - dhjetor	Zyrtarët e DA-së	UA.Nr.16 /Vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
	Objekte të qasshme për nxënës me nevoja të veçanta	Pa kosto	Janar - dhjetor	DA	PZHKA
	Motivimi, këshillimi, si dhe marrja e masave për integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në	Pa kosto	Janar - dhjetor	DA MASHTI	Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta edukative- arsimore Nr.07.2012

		klasat e rregullta				
		Identifikimi i rasteve të braktisjes së shkollës, riintegrimi i nxënësve në shkolla	Pa kosto	Janar-dhjetor	DA, MASHTI	UA-Nr.19/2012 Fuqizimi i ekipeve për parandalimin dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrim në arsimin e obliguar
		Zbatimi i protokollit për parandalimin dhe referimin e dhunës në shkollat e komunës	Koston e bartë organizata KEC& FIT	Janar-dhjetor	MASHTI, DA, KEC, FIT	Plani i veprimit për zbatimin e protokollit për parandalimin dhe referimin e dhunës në shkollat e komunës
1.	Organizimi dhe mbajtja e garave të ndryshme	Garat e fizikës, matematikës, në pikturë, në ese, garat e diturisë, garat sportive	Me kosto	Janar - dhjetor	MASHTI, DA, shoqatat	Plani i DA-së
3	Mbikëqyrje dhe monitorim i vazhdueshëm në të gjitha institucionet e nivelit parauniversitar, lidhur me përkrahjen dhe rritjen e përgjegjësisë	Monitorimi i mirëmbajtjes së pastërtisë në shkolla	Pa kosto	Janar-dhjetor	Zyrtarët e DA-së	Ligji i Arsimit Parauniversitar, PZHKA
		Monitorimi i sigurimit të objekteve shkollore, monitorimin e shpenzimeve komunale në secilën shkollë	Pa kosto	Janar-dhjetor	DA, Drejtoria e Prokurimit	Ligji i Arsimit Parauniversitar
			Pa kosto	Janar-dhjetor	Zyrtarët e DA-së	Ligji i Arsimit Parauniversitar/ Ligji për Menaxhimin e Financave Publike
		Mentorimi i mbarëvajtjes së procesit mësimor të	Pa kosto	Janar-dhjetor	Zyrtarët e DA-së, SIA-Mitrovicë	Ligji i Arsimit Parauniversitar

		shkollave të tri niveleve				
		Përgatitjet për shpalljen e konkursit për vendet e lira të punës	Pa kosto Pa kosto	Janar - dhjetor Janar - dhjetor	DA DA, zyra e personelit, MASHT	Ligji i Arsimit Parauniversitar, UA.Nr10/2018, UA. Nr 7/17, UA.Nr.15 /2019, Përzgjedhja e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve
		Analiza e normave të mësimdhënësve, vlerësimi i drejtorëve të shkollave	Pa kosto Pa kosto	Janar - dhjetor Janar - dhjetor	DA, zyrtarët e DA-së	Ligji i Arsimit Parauniversitar, UA.Nr10/2018, Udhëzimi Administrativ Nr.106/2020
4	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë dhe zbatimi i KK-së	Vlerësimi i shkollave për fushatë të cilësisë, monitorimi i vlerësimit të cilësisë	Pa kosto	Janar - dhjetor	Zyrtarët e DA-së, MASHTI, Instituti Pedagogjik / Sektori i inspektimit Mitrovicë	Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit / UA.Nr.24/2016 PËR SIGURIM TË CILËSISË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR
		Vazhdimi i trajnimit të mësimdhënësve komform kurrikulës së re	Pa kosto	Janar - dhjetor	Zyrtarët e DA-së, trajnerët e KK-së	<i>Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar</i>
		Monitorimi i planave vjetore, dymujore dhe ditore	Pa kosto	Janar - dhjetor	Zyrtarët e DA-së	<i>Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar</i>
		Vlerësimi i dosjeve të mësimdhënësve	Pa kosto	Shkurt - mars	Zyrtarët e DA-së	<i>Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar</i>
		Nxitja e nxënësve dhe promovimi i	Pa kosto	Mars - qershor	Zyrtarët e DA-së	Plani zhvillimor Komunal i Arsimit në Vushtrri

	dijes në olimpiada që mbahen jashtë komunës				
	Bashkëpunimi me ndërmarrje, angazhimet për kryerjen e praktikave	Pa kosto	Janardhjetor	DA, ndërmarrje	Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale në Kosovë 2013/2020 Nr.01B-101
	Organizimi i javës të dyerve të hapura për nxënësit e klasave të IX-ta, ndarja e fletushkave për klasat e IX-ta	Përcaktohet në bazë të numrit të nx.	Janardhjetor	DA, Qendra e karrierës	<i>Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar</i>
	Organizimi i provimit të maturës shtetërore 2022	Pa kosto	Qershor-gusht	DA	Ligji Nr. 03/L-018 për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore
	Organizimi i testit të arritshmërisë 2022	Pa kosto	Qershor-gusht	DA	Plani i DA-së

SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Objektivat:

- Funkcionalizimi dhe digjitalizimi i plotë i të gjitha qendrave të mjekësisë familjare dhe ambulancave;
- Riorganizimi dhe reformimi i sektorit të shëndetit oral;
- Avancimi, modernizimi dhe fuqizimi i punës diagnostike në shëndetin primar;
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mjekëve, infermierëve dhe puntorëve tjerë shëndetësorë;

- Fuqizimi i punës në aspektin e preventivës në shëndetin primar;
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në shtëpi për persona të palëvizshëm;
- Ofrimi i kujdesit parësor shëndetësor për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës;
- Edukimi shëndetësor si: parandalimi i sëmundjeve, imunizimi dhe vaksinimi;
- Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesi elementar shëndetësor, duke përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
- Kujdesi shëndetësor riprodhues dhe planifikimi familjar;
- Kujdesi shëndetësor ndaj nënës, fëmijës dhe adoleshentëve;
- Kujdesi për shëndetin mendor i bazuar në bashkësi, rehabilitimi;
- Zbulimi i hershëm i sëmundjeve ngjitëse dhe raportimi i tyre;
- Promovimi i shëndetit oral dhe kujdesi themelor stomatologjik;
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore diagnostike; analizave laboratorike dhe imazheve rëntgenologjike në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor;
- Vizitat sistematike për nxënësit;
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i personelit shëndetësor;
- Menaxhimi sa më i mirë dhe shpërndarja e barërave në KPSH;
- Kujdesi për të sëmurët me sëmundje kronike, si dhe ata që gjenden në stadin terminal të sëmundjes;
- Rritja e të hyrave, duke rritur përgjegjësinë për mbledhjen e këtyre të hyrave, si dhe menaxhimi sa më i mirë i fondeve të dedikuara për KPSH.

Viti 2022, ashtu si viti paraprak do jetë vit i përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, duke ju ofruar qajse më të mirë qytetarëve në shërbimet shëndetësore, të cilat i ofron KPSH, përmes QENDRËS KERYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE si njësi themelore, si dhe qendrave tjera shëndetësore (10 QMF dhe 9 AMF), të shtrira në të gjithë territorin e Komunës së Vushtrrisë. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2022 besojmë se do të finalizohet ndërtimi i QKMF-së së re, e cila do jetë e kompletuar dhe do të ofrojë shërbime shëndetësore profesionale të një kualiteti të lartë për një komunitet të madh të qytetarëve të Komunës Vushtrri. Ky investim do të ndikojë në përmirësimin e qasjes në shërbime shëndetësore dhe në mënyrë indirekte do të rritë cilësinë e shërbimeve për qytetarët e komunës. Gjatë vitit 2022 kemi planifikuar që të ndërtojmë dhe funksionalizojmë edhe 2 minilaboratore dhe një laborator kryesor diagnostik në QKMF-në e re. Me këte do të përmirësojmë qasjen në shërbimet e laboratorit, duke ndërtuar laborator për QMF Lumadh dhe QMF 3 Vushtrri, si dhe laboratorin që do jetë në QKMF-në e re. Gjithsej do kemi 4 laboratore në shërbim të qytetarëve dhe që do të rrisin kënaqshmërinë e qytetarëve në shërbimet që ne ofrojmë. Për fat të keq kemi pas vetëm një laborator diagnostik në KPSH për qytetarët e komunës, kurse qytetari ka pas vështirësi në qasjen në këtë laborator, për shkak të largësisë nga qendrat e pacientit ka marrë shërbime shëndetësore, pastaj fluksi i madh i qytetarëve në një laborator që indirekt ka vështirësuar punën e stafit tonë.

Buxheti për vitin 2022 për KPSH në Vushtrri është 2,475.419.00 euro.
Grandi qeveritar 2,425,419.00, ndërsa të hyra vetanake 50,000.00 euro.

Shpërndarja sipas kategorive ekonomike:
 Paga dhe mëditje 1,902,449.00 euro.
 Mallëra dhe shërbime 540,000.00 euro.
 Investime kapitale 193,000.00 euro.
 Subvencione dhe transfere 242,540.00 euro.
 Shpenzime komunale 58,000.00 euro.

Investime kapitale për vitin 2022		
1	Ndërtimi i aneksit në QKMF (depo dypjesësh dhe garazh)	40000
2	Teknologji informative	15000
3	Pajisje mjekësore	68000
4	Furnizim me inventar	30000
5	Renovimi dhe ngjyrosja e QMF-1	30000
6	Ndërtimi i reapsionit në objektin e ri të QKMF	4500
7	Rehabilitimi dhe izolimi i rëntgenit, si dhe ventilimi për objektin e ri të QKMF	43523
8	Furnizimi me pajisje për lavanderi	6000
9	Furnizimi dhe montimi i kamerave në QMF në Maxhunaj, Pantinë, Smrekonicë dhe Druar	10000
10	Bashkëfinancim me donatorë	30000
	Totali	277023

Qendra për punë sociale

Objektivat Çka dëshironi të arrini	Veprimi/Aksioni Cilat janë veprimet për t'i përmbushur objektivat	Afati kohor për përfundim /Përmbushjen e aktivitetit	Kostoja financiare	Rezultatet e pritura (çfarë efekti do të ketë veprimi)
<p>I. Ofrimi sa më efikas i ndihmës dhe shërbimeve të qytetarëve në harmoni me legjislacionin në fuqi</p>	<p>Veprime të mbështetura në respektimin dhe implementimin e legjislacionit primar dhe sekondar. -Marrëveshje të mirëkuptimit mes MPMS dhe institucioneve tjera. -Rregullore dhe akte tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale.</p>	<p>I përhershëm</p>		<p>Ngritja e cilësisë së punës, efikasitetit dhe racionalizimit</p>
<p>II.MBROJTJA E DREJT PËRDREJTË E SHFRYTËZUESVE</p> <p>1.Shërbimi i SAS-it - Implementimi i Ligjit Për Skemën e Ndihmës Sociale</p> <p>-Identifikimi dhe përzgjedhja e drejtë e shfrytëzuesve të ndihmës sociale</p> <p>Përmirësimi i kushteve të jetesës</p>	<p>-Informimi dhe udhëzimi i qytetarëve lidhur me kriteret e parapara me LSNS dhe të drejtat e aplikimit në ndihmë. -Informimi i aplikuesve për detyrimet dhe afatet e riaplikimit në SNS. -Shqyrtimi në afat ligjor i kërkesave të reja për ndihmë sociale në bazë të verifikimit në terren dhe dokumentacion përkatës.</p>	<p>I përhershëm</p> <p>I përhershëm</p> <p>I përhershëm</p>	<p>Kostoja e paraparë me Ligjin e SNS për anëtar të familjes</p>	<p>Ngritja e cilësisë së punës, efikasitetit në punë. Zbutja e varfërisë dhe rritja e mirëqenies sociale të qytetarëve.</p>

<p>personave në nevojë sociale</p> <p>-Raportimi mbi punën e sektorit</p>	<p>b) Respektimi dhe implementimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit mes MPMS dhe institucioneve tjera.</p> <p>c) Rregullore dhe akte tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale.</p> <p>d) Doracakëve si ai për mbrojtjen e fëmijëve, -komunikimi me fëmijë -për strehim familjar, etj.</p> <p>Identifikimi dhe vënia nën kujdestari të fëmijëve pa kujdes prindëror, strehimi familjar, përcjellja e zhvillimit dhe edukimit të tyre, vendosja në strehimin institucional dhe përcjellja e tyre përmes menaxherit, adoptimi i fëmijëve të braktisur.</p> <p>Aktivitetet preventive në parandalimin e këtyre dukurive, Propozimi i masave adekuate disiplinore me qëllim të resocializimit dhe riedukimit, si dhe mbikëqyrja e</p>	<p>I përhershëm</p> <p>I përhershëm</p>	<p>Ngritja e përgjegjësisë në punë dhe kualitetit të punës.</p> <p>Rritja e kualitetit të shërbimeve</p>
<p>2.Shërbimi social</p>		<p>I përhershëm</p>	

<p>-Respektimi i legjislacionit, ngritja e efikasitetit zgjedhjen problemeve</p>	<p>masave të shqiptuara, pjesëmarrja në seancat gjyqësore.</p> <p>Veprimi në propozimin e gjykatës për besimin e fëmijëve, realizimi i kontaktit të fëmijës me prindin tjetër.</p> <p>Përcjellja e zhvillimit të fëmijëve nga prindët e shkurorëzuar.</p> <p>Identifikimi i tyre, trajtimi psiko-social, strehimi i tyre i përkohshëm në familje tjetër apo institucion, trajtimi i familjes, bashkëveprimi me shkolla dhe subjekte tjera.</p>	<p>I përhershëm</p>		<p>Zhvillimi, rritja dhe edukimi normal i fëmijëve.</p>
<p>-Fëmijë dhe rini, trajtimi adekuat dhe mbrojtja e fëmijëve pa kujdes prindëror</p>	<p>Identifikimi i tyre, vlerësimi mbi nevojat për strehim, shërim dhe rehabilitim, udhëzim familjeve për shkollim special</p>	<p>I përhershëm</p>	<p>Kostoja e paraparë nga DPSF-ja për strehimin familjar dhe institucional</p>	<p>Resocializimi dhe riedukimi i këtyre fëmijëve, integrimi në rrethin mikro-social, si dhe preventiva tek fëmijët me sjellje të mundshme sociale.</p> <p>Ngritja e kualitetit të shërbimeve me qëllim të ngritjes dhe edukimit të drejtë të fëmijëve.</p>
<p>-Fëmijët dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, efikasiteti në resocializim dhe riedukimin e tyre</p> <p>-Fëmijët e prindërve</p>	<p>Puna këshillëdhënëse, trajtimi psiko-social i tyre dhe familjes</p>	<p>I përhershëm</p>		<p>Reintegrimi i tyre në familje dhe shoqëri</p>

<p>kontest të shkurorëzimit dhe të shkurorëzuar, mundësia e pajtimit dhe ribashkimit familjar</p> <p>-Fëmijët dhe rinia të keqtrajtuar- trafikuar dhe që shfrytëzojnë substancë psiko-aktive</p> <p>-Fëmijët me nevoja të veçanta</p>	<p>Trajtimi i bashkëshortëve në sanimin e marrëdhënieve dhe fëmijëve të tyre, në raste të nevojshme edhe familjes së gjërë, që kanë ndikim të bashkëshortët, vlerësimi i përshtatshmërisë për besimin e fëmijëve, dhënia e mendimit dhe propozimit gjykatave për besimin e fëmijës.</p>	<p>I përhershëm</p> <p>I përhershëm</p>		<p>Ofrimi kualitativ i shërbimeve</p> <p>Sanimi i marrëdhënieve bashkëshortore dhe familjare.</p>
<p>-Të rriturit, mbrojtja adekuate e të rriturve me sjellje të çrregulluara dhe që kanë rënë në konflikt me ligjin</p> <p>Bashkëshort me marrëdhënie të çrregulluara bashkëshortore, përmirësimi i marrëdhënieve reciproke</p>	<p>Trajtimi i tyre psiko-social, vendosja në familje tjetër apo në strehimore.</p> <p>Identifikimi, trajtimi dhe ofrimi i shërbimeve adekuate për implementimin e nevojave të të moshuarve pa kujdes familjar dhe pa mjete për jetesë, strehimi i tyre institucional, pjesëmarrja gjithëpërfshirëse e punëtorëve në trajnime të ndryshme.</p>			<p>Rruajtja e kualitetit të shërbimeve dhe konfidencialitetit.</p> <p>Ofrimi i shërbimeve kualitative</p>

Shërbimet rezidenciale

- Sigurimi i një ambienti të qetë dhe të përshtatshëm i personave me aftësi të kufizuara në këtë qendër;
- Përcjellja e vazhdueshme e gjendjes shëndetësore dhe emocionale të rezidentëve, përcjellja për një jetë të dinjitetshme;
- Bashkëpunimi me partnerët aktual dhe zgjerimi i bashkëpunimit me komunën, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, thithja e ndonjë donacioni të mundshëm me qëllim të përmirësimit të standardit sa më të mirë për rezidentët;
- Organizimi i aktiviteteve të lira dhe puna ekipore për rezidentët. Në vitin 2022 kemi planifikuar që kopshtin e shtëpisë ta zgjerojmë dhe të mbjellim më tepër sipërfaqe, por kemi planifikuar edhe t'i mbajmë 4 pikniqe njëditore në natyrë dhe të organizojmë lojëra, shëtitje, gjimnastikë, vallëzim, muzikë, vizatim;
- Mbajtja e komunikimit dhe bashkëpunimit në nivel me stafin në përgjithësi dhe rezidentët në veçanti në mënyrë që të mbajmë një situatë të qetë dhe relaksuese brenda shtëpisë;
- Respektimi dhe avancimi i të gjitha të drejtave dhe lirive të rezidentëve, duke u bazuar me ligjet e aplikueshme në Kosovë dhe më gjerë për këtë kategori të njerëzve.

Administrata

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Administratës është e organizuar në këta sektorë:

1. Zyra e gjendjes civile;
2. Sektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative;
3. Qendra për shërbim me qytetarë;
4. Zyra për të drejtat e njeriut.

Objektivi i përgjithshëm strategjik:						
Shërbime administrative kualitative, të qasshme, të bazuara në procedura administrative të arsyeshme dhe duke përdorur metodat e e-qeverisjes, të orientuara kah nevojat e qytetarëve dhe bizneseve.						
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Përgjegjës	Mbështetës	Kostoja totale	Burimi i financimit	Produkti
Funksionalizimi i Arkivit të komunës	Qershor 2022	Drejtoria për Administratë & DKRS	Të gjitha drejtoritë			Arkiv funksional

Vënia në funksion dhe inventarizimi i deposë së komunës	Shtator 2022	Drejtorja për Administratë & Drejtorja për Prokurim		20.000		Depo funksionale
Furnizim me TI dhe pajisje të tjera	Maj 2022	Drejtorja për Administratë & Drejtorja për Prok.		10,000.00	Komuna	Pajisje të TI
Rregullimi dhe mirëmbajtja e sistemit të klimatizimit dhe ngrohjes	Janar 2022	Drejtorja për Administratë & Drejtorja për Prokurim		50.000.00	Komuna	Sistemi i klimatizimit funksional
Renovimi dhe rregullimi i tualeteve të objektit të komunës	Shtator 2022	Drejtorja për Administratë & Drejtorja për Prokurim		30.000.00	Komuna	Tualetet e rregulluara
Mirëmbajtja e ashensorit, gjeneratorit, sistemit të radhës dhe dyerve magnetike	Janar 2022	Drejtorja për Administratë		15.000€		Kontratat e nënshkruara për mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve

Zyra e gjendjes civile

Qëllimi kryesor (objektivat)	Aktiviteti (detyrat)	Afatet	Bartësit	Vërejtje
1. Përditësimi i shënimeve dhe të dhënave personale për të gjithë qytetarët në Regjistrin qendror elektronik të gjendjes civile dhe administrimi i regjistrave themeltar fizik.	1.1.Verifikimi i qytetarëve në regjistrin themeltar elektronik, unifikimi i të dhënave dhe shënimeve me regjistrin themeltar fizik dhe elektronik; 1.2.përditësimi i shënimeve dhe regjistrimi i shtetasve në regjistrin themeltar dhe regjistrin qendror elektronik; 1.3 përditësimi dhe regjistrimi në regjistrin themeltar dhe qendror të vendbanimit dhe vendqëndrimit; 1.4 regjistrimi i shtetasve të huaj në regjistrin qendror; 1.5. regjistrimi i personave të natyralizuar sipas vendimit të MPB-së.	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi i Zyrës së gjendjes civile dhe zyrtarët e gjendjes civile	
2. Shqyrtimi i të gjitha kërkesave dhe nxjerrja e vendimeve për korrigjimin, ndërrimin dhe regjistrimin me vonesë të fakteve të lindjes dhe fakteve të vdekjes.	2.1. Nxjerrja e vendimeve për korrigjime të të dhënave personale; 2.2. për ndërrim të emrit personal; 2.3. për regjistrim me vonesë të faktit të lindjes dhe vdekjes; 2.4. për anulimin e regjistrimeve të faktit të lindjes; 2.5. për korrigjimin e akteve të lindjes, martesës dhe vdekjes; 2.6. për korrigjimin e librit fizik të lindjes, martesës dhe vdekjes.	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi i Zyrës së gjendjes civile dhe zyrtarët e gjendjes civile	
3.Regjistrimi i të gjitha fakteve të të lindurve dhe të të vdekurve në regjistrat themeltar, shtypja dhe mbajtja e akteve në mënyrë korrekte dhe cilësore, duke krijuar dosje për secilin rast dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve.	3.1.Regjistrimi i fakteve të lindjeve, martesave dhe vdekjeve në regjistrin themeltar dhe në regjistrin qendror elektronik të gjendjes civile; 3.2.regjistrimet e mëvonshme në bazë të vendimeve; 3.3. regjistrimet e veçanta (speciale), faktet që ndodhin jashtë vendit; 3.4 regjistrimi i fëmijëve të adoptuar në bazë të vendimit të gjykatës; 3.5. gjenerimi dhe lëshimi i numrit personal.	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi i Zyrës së gjendjes civile dhe zyrtarët e gjendjes civile	
4. Regjistrimi i të gjitha martesave	4.1 Informimi i palëve për kushtet dhe procedurat e kurorëzimit; 4.2.shpallje e martesave;	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi i Zyrës së gjendjes	

brenda orarit të punës dhe regjistrimi i të gjitha martesave jashtë selisë së komunës dhe jashtë orarit të punës.	4.3.regjistrimi i shtetaseve të huaj në regjistrin qendror në rastin e paraqitjes së kërkesës për kurorëzim; 4.4.aktet arkivohen në dosje sipas lëndës dhe digjitalizohen.		civile dhe zyrtarët e gjendjes civile	
7. Ruajtja e fshehtësisë të të dhënave personale dhe komunikimi i tyre vetëm personave që i parasheh ligji.	7.1.Të dhënat personale i komunikohen vetëm personit për të cilin mbahen shënimet; 7.2.certifikatat dhe dokumentet i jepen vetëm personit që i përkasin; 7.3. ruajtja e regjistrave dhe dosjeve me të DHP në orman metalik ku siguria e tyre është e garantuar.	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi i Zyrës së gjendjes civile dhe zyrtarët e gjendjes civile	

Sektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative

Objektivat	Aktiviteti (detyrat)	Afatet	Bartësit	Vërejtje
1.Funksionaliteti i tërë sistemit të teknologjisë informative të administratës së komunës	1.1 Implementimi i të gjitha politikave dhe procedurave të TI; 1.2 kujdesi për zbatimin e politikës së sigurisë së rrjetit, shfrytëzimit të resurseve të TI;	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi i sektorit	
2.Administrimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë për të siguruar qasje maksimale	2.1 Administrimi i serverëve dhe pajisjeve tjera qendrore të sistemit të TI në Komunë; 2.2. mirëmbajtja, instalimi, konfigurimi, testimi dhe zgjerimi i rrjetit; 2.3 formatizime, instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshëm, si dhe zgjidhja e problemeve të ndryshme softuerike; 2.4 administrimi dhe mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare, aplikacioneve dhe bazave të të dhënave të komunës.	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi i sektorit, zyrtari i TI	
3. Ofrimi i shërbimeve të përkthimit	3.1. Përkthimi i të gjitha dokumenteve sipas kërkesave të zyrtarëve të administratës komunale.	Gjatë tërë vitit	Përkthyesi	
4. Ofrimi i shërbimeve të lekturës	4.1 Lekturimi i dokumenteve të kuvendit, kryetarit dhe dokumenteve të shërbimeve tjera sipas kërkesave të zyrtarëve të administratës komunale.	Gjatë tërë vitit	Lektori	

Qendra e shërbimit për qytetarë

Qëllimi kryesor (objektivat)	Aktiviteti (detyrat)	Afatet	Bartësit	Vërejtje
I. Pranimi i të gjitha kërkesave/ankesave të parashtruara nga qytetarët/bizneset dhe grupet e interesit.	1-1 .Pranimi dhe regjistrimi i lëndëve në sistem; 1.2 pranimi dhe skanimi i të gjitha lëndëve të parashtruara nga palët, drejtuar institucionit të komunës.	Gjatë gjithë vitit	Zyrtarët e QSHQ-së	
3.Përcjellja e kërkesave /lëndëve tek drejtoritë përmes sistemit dhe përmes dorëzimit fizik, kurse gjatë vitit 2022 do të përpiqemi që dorëzimi fizik të eliminohet, do të përdoret në raste kur është domosdoshme.	3.1 Regjistrimi i lëndëve në librat e protokollit sipas drejtorive/zyrave përkatëse; 3.2 dorëzimi i lëndëve tek drejtoritë/zyrat përkatëse; 3.3.pranimi i postës dhe shpërndarja e saj tek zyrtarët përgjegjës.	Gjatë gjithë vitit	Recepcionisti (dërguesi i postës) i QSHQ-së	Prej janarit deri në qershor do të përpiqemi që dorëzimi fizik i lëndëve të eliminohet (vetëm në raste kur është e nevojshme)
4 Protokollimi i të gjitha dokumenteve komunale me një protokoll unik të gjeneruar nga sistemi i softuerit.	4.1 Protokollimi i të gjitha dokumenteve komunale me numër protokollit nga sistemi i softuerit.	Gjatë gjithë vitit	QSHQ-së	

KULTURË, RINI, SPORT

Biblioteka

Nr	Objektivat	Aktivitetet	Periudha e planifikuar për realizim	Bartësit e aktiviteteve
1.	Vazhdimi i pasurimit të bibliotekës së qytetit	Organizimi i kampanjës me qëllim të pasurimit të bibliotekës me libra	Janar – dhjetor 2022	DKRS dhe OJQ, klubet letrare
2.	Ofrimi i mundësive për leximin e titujve të rinj edhe për lexuesit nga bibliotekat e terrenit.	Shpërndarja e librave që janë në numër të madh të ekzemplarëve nga biblioteka amë në ato të terrenit	Janar – dhjetor 2022	<ul style="list-style-type: none">• DKRS
3.	Përkrahja e autorëve të rinj	Organizimi i promovimeve të ndryshme të librave, qoftë të krijuesve shkencorë, qoftë të atyre të rinj	Janar – dhjetor 2022	<ul style="list-style-type: none">• DKRS,• klubet letrare në Vushtrri
4.	Zbulim i librave të rrallë në fushën e publikimeve	Organizimi i muajit ku do bëhet zbulimi i librit të rrallë në nivel komune, veçanërisht nëpër shkolla të komunës	Janar – mars 2022	<ul style="list-style-type: none">• DKRS,• DA
5.	Pasurimi i bibliotekave me tituj të rinj	Hartimi i listës së librave të kërkuara nga lexuesit dhe e librave mungesë për bibliotekën amë dhe ato në terren	Janar – qershor 2022	DKRS, klubet letrare, profesorë të shkollave fillore dhe të mesme
	<u>Muzeu</u>			
1.	Inicimi i ndërrimit të emërimit të “Muzeut Komunal Historik Etnografik”	Për të mos u kufizuar vetëm me fushat nga historia dhe etnografia, është më se e arsyeshme t’i ndërrohet emërtimi, në “Muzeu i Vushtrrisë”	Janar – qershor 2022	<ul style="list-style-type: none">• DKRS,• Zyra ligjore,• Muzeu historik etnografik i qytetit
2.	Rrethimi i oborrit të objektit të Muzeut të Vushtrrisë, gjegjësisht monumentit –Shtëpia	Rrethimi apo kufizimi i oborrit të Muzeut të Vushtrrisë planifikohet të realizohet me gjethe, gjegjësisht muri të gjallë, për	Janar – mars 2022	<ul style="list-style-type: none">• DKRS

	e Mahmut agë Gjinollit në Muze të qytetit	arsye estetike, por edhe si mundësi ndalimi i qëndrimit të qenëve endacakë brenda oborrit të muzeut		<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Prokurimit dhe Financave
3.	Hapja dhe funksionimi i objektit të Muzeut të Vushtrrisë, gjegjësisht monumentit –Shtëpia e Mahmut agë Gjinollit në Muze të qytetit	Meqenëse enterieri i muzeut është furnizuar me inventar (vitrina), si dhe është transportuar pasuria muzeale në shtëpinë e përhershme, në monumentin “Shtëpia e Mahmut agë Gjinollit”, gjatë pjesës së parë të vitit 2022 do të organizohen ekspozitat e përkohshme dhe të përhershme të muzeut	Janar- qershor 2022	<ul style="list-style-type: none"> • DKRS
4.	Kthimi i ekspozateve arkeologjike të gjetura gjatë gërmimeve arkeologjike në Kalanë e Vjetër të Vushtrrisë, të cilat ruhen në Institutin Arkeologjik të Kosovës.	Implementimi i projektit: “Kthimi dhe prezantimi i ekspozateve arkeologjike në Muzeun e Vushtrrisë”. Ekspozatat arkeologjike janë zbuluar gjatë gërmimeve arkeologjike në Kalanë e Vushtrrisë, në mungesë të një objekti për ruajtjen dhe ekspozimin e tyre, ato janë ruajtur në Institutin Arkeologjik të Kosovës	Janar- qershor 2022	<ul style="list-style-type: none"> • DKRS, • Instituti Arkeologjik i Kosovës
5.	Blerja e ekspozateve të identifikuara gjatë vitit 2021	Përmes blerjes së ekspozateve të identifikuara gjatë vitit 2021, përpos që do shpëtohen ekspozatat e ekspozuara në terrene të ndryshme, gjithashtu edhe do pasurohet Muzeu i Vushtrrisë	Janar- dhjetor 2022	<ul style="list-style-type: none"> • DKRS
6.	Organizimi i odës tradicionale	Improvizimi dhe prezantimi i “odës” me elementet përcjellëse.	Janar- qershor 2022	<ul style="list-style-type: none"> • DKRS
7.	Organizimi i dhomës qytetare	Improvizimi dhe prezantimi i “dhomës qytetare” me elementet përcjellëse	Janar-qershor 2022	<ul style="list-style-type: none"> • DKRS

8.	Organizimi i dhomës së oxhakut (kuzhina tradicionale)	Improvizimi dhe prezantimi i “dhomës së oxhakut (kuzhina tradicionale)” me elementet përcjellëse	Janar- qershor 2022	• DKRS
9.	Organizimi i sektorit etnologjik	Prezantimi i pasurisë etnologjike	Janar- qershor 2022	• DKRS
10.	Organizimi i sektorit të teknologjisë	Prezantimi i pasurisë i sektorit të teknologjisë	Janar- qershor 2022	• DKRS
11.	Organizimi i dhomës për persona me nevoja të veçanta	Realizimi i aktiviteteve të ndryshme edukative me personat me aftësi dhe nevoja të veçanta	Qershor dhjetor 2022	• DKRS
12.	Organizimi i sektorit të arkeologjisë dhe historisë	Prezantimi i pasurisë arkeologjike dhe historike	Prill nëntor 2022	• DKRS
13.	Krijimi i sektorit të “Luftës së fundit 1998-1999”	Organizimi i ekspozitës të veçantë të Luftës së fundit 1998-1999, në bashkëpunim me familjarët e dëshmorëve, martirëve dhe shoqatat e dala nga lufta	Janar-dhjetor 2022	• DKRS
14.	Hulumtimi dhe identifikimi i personave të burgosur politik gjatë periudhës 1944-1950 në Komunën e Vushtrrisë.	Hulumtimi dhe mbledhja e biografive të burgosurve politik gjatë periudhës 1944-1950 në Komunën e Vushtrrisë	Janar – prill 2022	• DKRS, • Bashkëpunëtorë të jashtëm
15.	Krijimi i Etno-parkut	Organizimi i një etno-parku të hapur në oborrin e muzeut (Monumenti “Shtëpia e Mahmut agë Gjinollit”), ku do të ekspozohen objekte të ndryshme kulturore nga arkeologjia dhe etnologjia	Janar – dhjetor 2022	• DKRS
16.	Hulumtimi i kulturës materiale	Vazhdimi i punës hulumtuese në fushën e kulturës materiale të luajtshme dhe të paluajtshme	Janar – dhjetor 2022	• DKRS

17.	Pasurimi i sektorit të videotekës dhe fototekës së muzeut	Hulumtimi në terren i fotografive dhe videove të vjetra	Janar – dhjetor 2022	• DKRS
18.	Botimi i një katalogu dhe fletëpalosjeje	Përgatitja e një katalogu dhe fletëpalosjeje të ekspozitave muzeale për vizitorë, ku do të prezantohen ekspozitat më të vlefshme dhe më interesante, të cilat i ka muzeu	Janar – dhjetor 2022	• DKRS
19.	Hulumtimi i artizanateve	Vazhdimi i punës në hulumtimin e zejtarive, të cilat u trashëguan dhe vazhdojnë të mbesin gjallë edhe sot	Janar – dhjetor 2022	• DKRS
20.	Ripërtëritja e traditave	Në bashkëpunim me Ansamblin e qytetit “Hasan Prishtina”, do të organizohen aktivitetet etno-folklorike për ripërtëritjen e traditave.	Maj – tetor 2022	• DKRS
	Arkivi			
1.	Pranimi dhe ruajtja e materialit arkivor	- Pranim – dorëzimi i lëndëve arkivore	Janar – dhjetor 2022	• DKRS, • Komisionin arkiv-gjykatë, • Institucione tjera lokale
2.	Gjetja e mënyrave për të qenë sa më efikase puna në arkiv	Ndarja e dokumentacionit në njësi arkivore, i cili është transferuar nga objekti i mëhershëm	Janar – dhjetor 2022	DKRS
3.	Efikasiteti i punës	- Vendosija e tiketave në kuti arkivore të dëmtuara gjatë transportimit nga objekti i mëparshëm	Janar - dhjetor 2022	DKRS
4.	Grumbullimi i materialit të nevojshëm për arkiv	- Kontrolli i regjistraturave jashtë arkivit në të gjitha institucionet lokale publike	Mars –shtator 2022	DKRS

5.	Sistemi i lëndëve arkivore	Vendosja e tyre në rafte sipas njësisive organizative	Janar – dhjetor 2022	DKRS
6.	Shërbimi ndaj publikut	Krijimi i këndit arkivor	Mars 2022	DKRS, Agjencia e Arkivave të Kosovës
	Kultura			
1.	Përmes përkujtimin të 17 Shkurtit, Ditës të Shpalljes të Pavarësisë të Republikës së Kosovës, synojmë të mbajmë të freskëta kujtimet për sakrificat e popullit tonë për arritjen e kësaj dite	- Homazhe; - Program artistik; - Hapja e ekspozitës me piktura; - Marshi i pavarësisë; - Program artistik për të rinj; - Orë letrare; - 17 Shkurt-manifestim i Ditës së Pavarësisë së Kosovës - Turne i hapur në pingpong	Shkurt 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna e Vushtrrisë, • DKRS, • Shoqatat e dala nga lufta, • Organizatat rinore, • Klubet sportive
2.	Vazhdimi i realizimit të shfaqjes	Premierë dhe 3 repriza	Shkurt, prill 2022	<ul style="list-style-type: none"> • DKRS
3.	Shfaqja e dytë	Premierë dhe 3 repriza	Prill, qershor 2022	<ul style="list-style-type: none"> • DKRS
4.	Shfaqja e tretë	Premierë dhe 3 repriza	Shtator, nëntor	<ul style="list-style-type: none"> • DKRS
5.	Përkujtimi “Epopëja e UÇK-së”	-Homazhe; -Program artistik; -Gara në pikturë; -Gara sportive shkollore; Sesion apo tryezë shkencore me të rinj, veçanërisht me nxënësit, me qëllim të njoftimit për heroizmin e familjes Jashari 5, 6 dhe 7 Mars - Epopeja -e UÇK-së	5,6 dhe 7 mars 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna e Vushtrrisë, • DKRS, • Shoqatat e dala nga lufta, • Shkollat e mesme të ulëta dhe të larta

6.	Shënimi "Dita e Gruas" – 8 Marsi	-Program artistik; -Orë letrare me poetet femra; -Ndeshje hendbolli, volejboli në konkurrencën e femrave -Dita e Gruas	8 mars 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna e Vushtrrisë, • DKRS, • Klubet sportive të femrave
7.	Shënimi i "Ditës Botërore të Shëndetit"	-Fushatë vetëdijësuese për shëndet më të mirë	7 prill 2022	Drejtoria e Shëndetësisë, DKRS, Organizatrat rinore, Shkollat e mesme të ulëta dhe të larta
8.	Shënimi i "Ditës së Tokës"	-Gara me piktorë të rinj	9 rill 2022	<ul style="list-style-type: none"> • DKRS, • Organizatat rinore
9.	Organizmi i manifestimit "Zëri më i mirë" - Vushtrria 2022	-Selektimi i të rinjve me aftësi këndimi; -Ushtrimi me të përzgjedhurit; -Organizimi i finales dhe shpallja e fituesve	25 prill - 9 maj 2022	<ul style="list-style-type: none"> • DKRS
10	Shënimi i Ditës së Pavarësisë të Kosovës	Aktivitete kulturore, sportive dhe rinore, homazhe akademi solemne	17 shkurt	DKRS
11	Përkujtimi i masakrës së Studimes "Studimja 99"	-Homazhe; -Akademi përkujtimore në Studime; -Turne memorial në shah "Studimja '99"; -Masakra e Studimes (2 Maji 1999)	maj 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Institucionet komunale, • Shoqatat e dala nga lufta e UÇK
12	Përkujtimi i masakrës së Vushtrrisë "22 Maji"	-Homazhe; -Akademi përkujtimore; - Masakra e 22 Majit (1999)	22 maj 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna e Vushtrrisë, • Shoqatat e dala nga lufta
13	Përkujtimi i masakrës së Familjes Gërxhaliu	-Homazhe; -31 maj, masakra ndaj familjes së Selatin Gërxhaliut	31 maj 2022	<ul style="list-style-type: none"> • DKRS, • Shoqatat e dala nga lufta e UÇK

21.	Shënimi i “Ditës së Flamurit” 28 Nëntori	Homazhe; -Program kulturo-artistik; -Ekspozitë kushtuar 28 Nëntorit; -Garë në piktura; -Garë në ese; -Aktivitete sportive: basketboll, hendboll, futboll, pingpong	28 nëntor 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna e Vushtrrisë; • DKRS; • Shoqatat e dala nga lufta; • Organizatat rinore; • Klubet dhe OJQ
22.	Shpallja e “Sportistit të vitit 2022”	Organizim i ngjarjes ku do të shpallet sportisti i vitit	24 dhjetor 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Sportistët nga Komuna e Vushtrrisë

INSPEKTIMET

Inspektorati i ndërtimit

MBIKËQYRJA INSPEKTUESE

- Inspektimi i të gjitha ndërtimeve në territorin e komunës
- Veprimi në parandalimin e ndërtimit të ndërtimeve pa leje ndërtimi
- Inspektimi i ndërtimeve të banimit shumëbanesor sipas protokolleve inspektuese

Nr.	Aktiviteti	Bartësit e aktivitetit	Bashkëpunimi me subjekte tjera relevante	Planifikimi
2	Marrjen e të gjitha masave ligjore në rast të mospërfilljes së legjislacionit, i cili është i aplikuar nga ana e personave të cilët kryejnë ndërtime pa leje	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit
3	Mbikëqyrja inspektuese dhe procedura për lëshimin e certifikatës së përdorimit për të gjitha objektet e ndërtimit të lartë, për lëshimin e lejes së përdorimit, së bashku me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor	Mars, prill
4	Për të gjithë ata pronarë, të cilët nuk kanë respektuar Ligjin për Ndërtim, do të merren masa ligjore, procedura për iniciimin e procedurave për kundërvajtje në Gjykatën Themelore për Kundërvajtje	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit
5			Drejtorinë për Urbanizëm dhe	

	Ndalimi i të gjitha punimeve sipas legjislacionit në fuqi	Inspektorët e ndërtimit	Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit
6	Ndalimin e të gjitha punëve ndërtimore pa leje nga organi kompetent	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit

7	Në raste të fillimit të punimeve ndërtimore pa leje të ndërtimit do të merren të gjitha masat sipas dispozitave ligjore	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit
8	Bashkëpunimi me organet relevante, Policinë e Kosovës	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit
9	Angazhimi në punë dhe detyrat e punës të përcaktuara me Ligjin për Ndërtimin, si dhe harmonizimi i punëve në bashkëpunim me drejtorin e drejtorisë	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit
10	Bashkëpunim me Drejtorinë për Kadastër, Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor - caktimi i pikave për objektet me leje ndërtimore	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Urbanizëm, Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	Gjatë tërë vitit

Inspektorati për mbrojtjen e mjedisit

Nr.	PËRMBAJTJA E PUNËVE	BARTËSI I PUNËVE	BASHKËPUNON ME SUBJEKTET	AFATI I KRYRJES SË PUNËVE
1	Angazhimi në zvogëlimin e faktorëve të ndotjes së mjedisit jetësor	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Bashkëpunoj me subjektet relevante	Gjatë tërë vitit
2	Analiza në vlerësime dhe rekomandime në lëmin e industrisë dhe burimeve urbane	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Drejtorinë për Urbanizëm DMA	Gjatë tërë vitit
3	Angazhimi në edukimin dhe në vetëdijësimin e popullatës në lëmin e mbrojtjes së mjedisit	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Bashkëpunim me qytetarët	Gjatë tërë vitit

4	Do të angazhohemi që të bëhet pastrimi i lumenjve “Silnica” dhe “Tërstena”	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	KRMH “Uniteti” njësia në Vushtrri	Gjatë tërë vitit
5	Gjatë muajit të higjienës: organizimi me struktura të ndryshme, qytetarë, nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, FSK-në, KFOR-in për pastrimin e rrugëve kryesore dhe shesheve para ndërtesave nga mbeturinat	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Kuvendi komunal, qytetarët, nxënësit, FSK-në, KFOR-in KRMH “Uniteti” njësia në Vushtrri	Prill

9	Përgatitja e programeve të ndryshme në pyllëzimin e sipërf. të pyjeve të degraduara	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Autoriteti qendror i pylltarisë	Shkurt mars
10	Do të angazhohemi në mbrojtjen e qytetarëve nga zhurma dhe vibracionet	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Autoriteti qendror i pylltarisë	Mars prill
11	Zvogëlimin e ndotjes nga transporti	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	SHPK-në	Gjatë tërë vitit
12	Ripyllëzimin e sipërfaqeve djerrë me fidane të reja dhe të shtojmë sipërfaqe të gjelbëruara në qytet	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Kuvendi komunal	Gjatë tërë vitit

13	Inspektimin e punëve të KRMH “Uniteti” njësia në Vushtrri gjatë pastrimit, larjes dhe freskimit të rrugëve të qytetit, si dhe do t’i përcjellim punët gjatë mirëmbajtjes dimërore të rrugëve lokale në komunë	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Ministrinë e Mbrojtjes së Mjedisit	Gjatë tërë vitit
----	---	-------------------------------------	------------------------------------	------------------

Inspektorati i komunikacionit

Nr.	Aktiviteti	Bartësi i aktivitetit	Bashkëpunimi me subjekte tjera	Periudha kohore
1	Mbikëqyrja dhe inspektimi i të gjithë operatorëve që merren me veprimtarinë mbi transportin e udhëtarëve dhe mallrave	Inspektori i komunikacionit	Policinë e Kosovës, gjykatën, inspektoratet qendrore dhe komunale	Gjatë tërë vitit

2	Inspektimi i Auto-taxi-ve	Inspektori i komunikacionit	Drejtorinë për Shërbime Publike	Gjatë tërë vitit
3	Operatorët "Taxi"	Inspektori i komunikacionit	Drejtorin për Shërbime Publike	Gjatë tërë vitit
4	Inspektimin e automjeteve të transportit të mallrave	Inspektori i komunikacionit	Bashkëpunim me qytetarë	Gjatë tërë vitit
5	Ndërmarrjet të cilat merren me transport të udhëtarëve (autobusët, kombibusët)	Inspektori i komunikacionit	Inspektoratet e resorëve tjerë	Gjatë tërë vitit
6.	Kontrollimin e vijave komunale urbane dhe ndërrurbane	Inspektori i komunikacionit	Drejtorin për Shërbime Publike	Gjatë tërë vitit
7	Angazhimi i kryerjes së detyrës me përpikëri, si dhe punët dhe detyrat që merren nga drejtori i Drejtorisë për Inspektime	Inspektori i komunikacionit		Gjatë tërë vitit

Inspektorati i higjienes – shërbimeve publike

Nr.	AKTIVITETI	BARTËSI I AKTIVITETIT	BASHKËPUNIMI	Periodha kohore
1.	Mbikëqyrje e objekteve komunale dhe pastërtisë së qytetit me rrethinë, me qëllim të ngritjes të cilësisë së higjienës në komunën tonë	Inspektorja e higjienës – shërbimeve publike	Drejtorinë për Inspektime dhe KRM "Uniteti"	Përgjatë tërë vitit
2.	Mbikëqyrje të mbajtjes së pastërtisë të sipërfaqeve publike në vendbanime	Inspektorja e higjienës – shërbimeve publike	Drejtorinë për Inspektime dhe KRM "Uniteti"	Përgjatë tërë vitit
3.	Mbikëqyrje e mbajtjes së pastërtisë dhe pamjes së jashtme të ndërtesave	Inspektorja e higjienës – shërbimeve publike	Drejtorinë për Inspektime dhe banuesit e ndërtesave	Përgjatë tërë vitit
4.	Mbikëqyrje e mbajtjes së pastërtisë së vitrinave të lokaleve, mbajtjen e pastërtisë së tregut	Inspektorja e higjienës – shërbimeve publike	Drejtorinë për Inspektime dhe pronarët e lokaleve afariste	Përgjatë tërë vitit

SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike bën rregullimin e qytetit dhe mbrojtjen e ambientit, mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale të asfaltuara dhe të rendit të katërt, rregullimin e qarkullimit të komunikacionit, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, parkingjet, transportin lokal, përcjell procedurën e pastrimit të ujërave atmosferike nga sipërfaqet publike, mbikëqyr punën e lëmit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të zeza, menaxhon procedurat e bartjes dhe deponimit të hedhurinave, pastrimin dhe larjen e rrugëve, shesheve dhe sipërfaqeve publike, mirëmbajtjen e shtratit të lumenjve, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e varrezave etj.

Në tabelat e mëposhtme është paraqitur në mënyrë të detajuar plani i punës së Drejtorisë për Shërbime Publike.

	Aktiviteti	Periudha	Në bashkëpunim
1	Përgatitja e dokumentacionit dhe mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale	Janar-mars	Policinë e Kosovës
2	Miratimi i Planit komunal pesëvjeçar për menaxhimin e mbeturinave 2022-2026	Janar -shkurt	Ndërmarrjen „UNITETI” OJQ „GAC”
3	Zotimet e mjeteve për inicim të procedurave të tenderimit për projektet që do të menaxhohen nga DSHP	Janar - tetor	DBTH, Drejtorinë e Prokurimit
4	Mirëmbajtja e kanalizimit atmosferik dhe i kanaleve të hapura	Mars-prill	Kompania „Uniteti”
5	Analiza e rrjedhës së qarkullimit të mjeteve motorike në bazë të senseve (kaheve) të lëvizjes në të gjitha rrugët e qytetit	Mars-prill	Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, SHMT
6	Plani i aktiviteteve për shënimin e muajit të higjienës	Mars-prill	Drejtorinë për Inspektime, KRH “Uniteti” dhe OJQ.
7	Hartimi i dokumentacionit teknik për mirëmbajtjen e varrezave	Prill-maj	
8	Mirëmbajtja (mirëmbajtja verore – plani i fshirje – larjes së rrugëve në qytet, mirëmbajtja e varrezave të qytetarëve, martirëve dhe dëshmorëve, mirëmbajtja dimërore)	Mars	Drejtorinë për Buxhet, dhe Drejtorinë për Prokurim
9	Përgatitja e dokumentacionit teknik për mirëmbajtjen e ndriçimit publik	Shkurt-mars	
10	Përgatitja e dokumentacionit teknik për sinjalizimin horizontal dhe vertikal		
11	Eliminimi i deponive ilegale	Shkurt- mars	Drejtorinë për Shërbime Publike, Uniteti

12	Analiza teknike e fraksioneve të mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrisë	Shkurt- mars	DSHP, Uniteti
13	Përgatitja e dokumentacionit teknik për tenderim – paramasat dhe paralogaritë për shërbimet tjera kontraktuese (ndërtimet e rrugëve me kubëza betoni, ndërtimi i trotuareve, parqet dhe sheshet)	Mars-prill	Drejtorinë për Buxhet, si dhe Drejtorinë për Prokurim
14	Hartimi i planit të mobilitetit-lëvizshmërisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion	Mars-qershor	Sektori për komunikacion (DSHP), Policinë e Kosovës
15	Plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores për sigurinë në komunikacion në territorin e Komunës së Vushtrisë, harmonizimi i saj me Ligjin për Sigurinë në Komunikacion, Ligjin për Rrugët, Ligjin për Transportin etj.	Prill-qershor	Drejtorinë e Inspektimeve, Policinë e Kosovës
16	Punë të ndryshme administrative për përgatitjen dhe organizimin e kompanive për transportin publik gjatë vitit shkollor	Gusht	Kompanitë transportuese
17	Përgatitja e paramasave dhe paralogarive për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve motorike të K. komunës	Gjatë tërë vitit, sipas nevojës	Drejtorinë për Buxhet, Drejtorinë për Prokurim
18	Implementim i proceseve - analizës teknike për ndarjen e mbeturinave në burim	Shtator	Ndërmarrjen Uniteti, Qendrën për paketim të mbetjeve të riciklueshme, OJQ-të
19	Përgatitja e dokumentacionit për sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve të komunës	Gjatë tërë vitit, sipas nevojës	Drejtorinë për Buxhet, Drejtorinë për Prokurim
20	Përgatitja e dokumentacionit për furnizimin me derivate lëndë djegëse dhe vajra për vetura për mjetet motorike të komunës	Gjatë tërë vitit, sipas nevojës	Drejtorinë për Buxhet, Drejtorinë për Prokurim
21	Implementimi i objektivave të Planit komunal pesëvjeçar të menaxhimit të mbeturinave	Gjatë tërë vitit, sipas nevojës	KRM “Uniteti”
22	Dekorimi i hapësirave në qytet	Nëntor-dhjetor	Drejtorinë për Buxhet, Drejtorinë për Prokurim

URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Objektivat::

- Urbanizimi i qytetit
- Mbrojtja e mjedisit
- Konservimi i zonës historike të qytetit

Prioritetet:

- Finalizimi i Hartës Zonale
- Konservimi i Zonës Historike
- Identifikimi dhe rregullimi i hapësirave publike
- Rregullimi i infrastrukturës

Më poshtë janë shënuar aktivitetet për të cilat DUMM ka përgatitur - Planin e punës për vitin 2022:

	Aktiviteti	Perioda	Në bashkëpunim me:	Vërejtje
1	Zbatimi i ligjeve në fuqi, udhëzimeve administrative dhe akteve tjera nënligjore që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Urbanizimit dhe Planeve Hapësinore	Janar - dhjetor	Të gjitha drejtoritë komunale që lidhet puna dhe aktiviteti i drejtorisë	Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
2	Menaxhimi i kërkesave për dhënien e kushteve ndërtimore dhe protokollit të rregullimit, pëlqimeve urbanistike	Janar-dhjetor	Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtorinë e Bujqësisë Drejtorinë e Inspektimeve	Sektori i urbanizimit
3	Menaxhimi i kërkesave për dhënien e lejeve ndërtimore, si dhe caktimi i pikave të ndërtimit sipas lejeve ndërtimore	Janar - dhjetor	Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtorinë e Bujqësisë Drejtorinë e Inspektimeve	Sektori i urbanizimit dhe planifikimit
4	Inicimi i procedurave për afstaltimin e rrugëve të aprovuara nga Kuvendi Komunal Vushtrri sipas Planit Zhvillimor Komunal	Janar - dhjetor	Drejtorinë e Financave, Drejtorinë e Prokurimit dhe drejtoritë tjera	Sektori i planifikimit

5	Mbikëqyrja e projekteve kapitale të komunës	Janar - dhjetor	Drejtorinë e Financave dhe Drejtorinë e Prokurimit	Sektori i planifikimit
6	Menaxhimi i sistemit të adresave në të gjithë territorin e komunës, si në qytet ashtu edhe në fshatra, duke përfshirë në sistem edhe menaxhimin e kërkesave të ndryshme për ndryshime të kërkuara	Janar - dhjetor	Të gjitha drejtoritë dhe institucionet tjera relevante	Sektori për sistemin e adresave
7	Ndihmon në kujdesin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë	Janar - dhjetor	Drejtorinë për Kulturë dhe Entin për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturo-historike të Kosovës	Sektori i urbanizmit
8	Finalizimi i Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë, bazuar në PZHK 2016-2024	Janar - dhjetor	Të gjitha drejtoritë dhe institucionet tjera relevante	
9	Inicimi i procedurava për mbështetjen nga Un-Habitat për Hartimin e vlerësimit vullnetar lokal dhe lokalizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm	Shkurt-qershor	Të gjitha drejtoritë dhe institucionet tjera relevante	DUMM
10	Inicimi i procedurava për mbështetjen nga Un-Habitat për Hartimin e planit të mobilitetit të qëndrueshëm urban	Janar-shtator	Të gjitha drejtoritë dhe institucionet tjera relevante	DUMM

Aktivite tjera të vazhdueshme të punës së përditshme të stafit, që dalin jashtë objektivave të drejtorisë dhe janë në kontinuitet të vazhdueshëm.

GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Sektori për kadastrë

Ky sektor do të fokusohet në shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave të palëve lidhur me regjistrimin në regjistrin e të drejtave mbi pronat e paluajtshme, siç janë:

- Regjistrimin e parcelave kadastrale;
- Regjistrimin e ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave (etazheve);

- Regjistrimin e përçojave që kanë rëndësi publike;
- Regjistrimin e hipotekave;
- Çregjistrimin e hipotekave;
- Regjistrimin e servitutit;
- Lëshimin e certifikatave, skicave, kopjeve të planit;
- Futjen e të dhënave të komasacionit në sistemin SIKTK për 20 zona kadastrale, të cilat deri më tani nuk janë futur në sistem;
- Evidentimin e pronave të uzurpuara;
- Lirimimin e pronave të uzurpuara, dhe
- Identifikimin e pronave bujqësore për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër.

Spektori për gjeodezi

Ky sektor do të shqyrtojë kërkesat e palëve për:

- bashkimin e parcelave;
- rregullimin e kufijve të parcelave dhe incizimin e gjendjes në terren;
- matjet tjera të nevojshme në kuadër të kompetencës ligjore;
- incizimin e pronës publike (rrugëve, objekteve, për nevojat e organeve);
- përpunimin e lëndëve të pjesës grafike për gjeodet dhe për kompanitë e licencuara;
- regjistrimin e ndërtesave dhe objekteve në planet kadastrale;
- kompletimin dhe sistemimin e dokumentacionit të administruar të komasacionit, i cili gjendet në drejtori dhe mundësia e digjitalizimit;
- bartja e të dhënave të gjendjes së ndryshuar në terren në elaborat dhe planet e punës-vektorët;
- bartja e të dhënave konform Ligjit të Agjencionit Kadastral të Kosovës;
- bashkëpunimi i ndërsjell me Agjencionin Kadastral të Kosovës, duke paraqitur raporte dhe të dhëna të nevojshme për punën e kryer, duke bërë sigurimin, përkatësisht kthimin e dokumentacionit - planeve të punës, të cilat mungojnë nga lufta;
- krijimin e kushteve më të përshtatshme teknike përmes sigurimit të mjeteve, kompjuterëve për gjeometri dhe për operatin kadastral;

Spektori për pronë

Ky sektor punën dhe aktivitetin e vet do ta përqendrojë në:

- Inicimin dhe zhvillimin e procedurës mbi uzurpimet e bëra të tokës, sipas kërkesës dhe detyrës zyrtare konform ligjit, veçanërisht në uzurpimet e bëra të pronës komunale në qytet dhe bashkësi lokale, përkatësisht fshatra;
- Përpilimin e akteve, vendimeve, konkluzioneve për gjitha fazat për procedurën e zhvilluar në fushën e uzurpimeve të eksproprijimit të paluajtshmërisë, të qarkullimit të paluajtshmërisë në pajtim me ligjin;
- Hartimin e akteve, propozim-vendimeve, kontratave lidhur me qarkullimin, bartjen, si dhe dhënien në shfrytëzim (me qira) të paluajtshmërisë në pronësi të komunës;
- Kujdesjen për zbatimin e aktvendimeve të ekzekutueshme;
- Ushtrimin e kallëzimit për kundërvajtje dhe penale, për procedurën e zhvilluar ndaj uzurpuesve arbitrar të tokës.

Aktivitetet që kanë për qëllim realizimin e prioriteteve të drejtorisë

Nr	Drejtoria	Objektivat	Aktivitetet	Afati	Kostoja	Pjesëmarrësit	Ndërlidhja
1	Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	Shpronësimi i pronave për realizimin e projekteve	Zhvillimi i procedurave të shpronësimit	Afati permanent	Ndikimi financiar nuk është përcaktuar me buxhet	Pjesëmarrësit tjerë Ministria e Financave	Ndërlidhja me realizimin e projekteve
Prioritet nr. 1 Shpronësimi – sipas kërkesave për shpronësim							
Prioritet nr. 2 Uzurpimet							
2		Objektivat - mbrojtja e pronës komunale	Zhvillimi i procedurave për lirimin e pronës komunale të uzurpuar	Afati permanent	Ndikimi financiar në euro është zero	Pjesëmarrësit tjerë, Drejtoria e Inspektiveve	
3		Objektivat - Zbatimi i aktvendimeve lidhur me ndarjen e pronës nga komasacioni, të lëshuar nga komisioni për komasacion	Futja e të dhënave në RDPP për zonat kadastrale në komasacion të përfundura	Afati Permanent	Ndikimi financiar në euro zero	Pjesëmarrësit tjerë Agjencioni Kadastral i Kosovës	
4		Raportimi para Kuvendit të komunës lidhur me pronat komunale	Informatë lidhur me pronat komunale të dhëna me qira	Shta-tor	Ndikimi financiar, zero		
5		Lista e pronave të paluajtshme të komunës	Përpilimi dhe azhurimi i listës të	Afati permanent	Ndikimi financiar zero euro	Pjesëmarrës tjerë Drejtoria për Bujqësi	

			pronave komunale				
6		Objektivat - Ngritja e efikasitetit në punë	Përgjigjja në kohë ndaj kërkesave	Afati permanent	Ndikimi financiar zero euro		

MBROJTJE DHE SHPËTIM

Hartimi i planit vjetor të punës për vitin 2022 ka për qëllim krijimin e prioriteteve dhe caktimin e detyrave sipas dinamikës së punës për koordinimin sa më efikas të drejtorisë me subjektet relevante të gjitha niveleve, të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejt dhe në mënyrë profesionale në raste të fatkeqësive natyrore dhe katastrofave tjera të mundshme, si dhe koordinimi i ekipeve emergjente me subjektet përkatëse në menaxhimin e situatave emergjente.

Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim është autoriteti më i lartë për zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë për gatishmëri emergjente dhe civile në komunë, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha subjektet pjesëmarrëse në situata emergjente.

Është përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave të nivelit komunal, vënien e standardeve të kryerjes së punës lidhur me gatishmërinë civile dhe reagimin emergjent në komunë dhe koordinimin e autoriteteve komunale për gatishmëri emergjente, varësisht nga karakteri dhe përmasat e fatkeqësisë.

Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim ka planifikuar që të merr masa të nevojshme për t'i përcjellë aktivitetet e shoqërisë (organizatat joqeveritare), të cilat do t'i mbështesin shërbimet emergjente gjatë periudhës së katastrofave.

Nr	Emërtimi i detyrave - aktiviteteve të planifikuara	Baza e planifikimit	Bartësit e aktiviteteve	Bashkëpunimi me:	Afati		Vërejtje
					Prej	Deri	
1.	Azhurnimi i planeve: Vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Plani për reagim emergjent	Udhëzimi administrativ për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikut	DMSH	Kryqin e Kuq, Policinë e Kosovës, NJPZSH, si dhe të gjitha bizneset që inkorporohen në këtë vlerësim	Gjatë vitit	Gjatë vitit	
2	Nxjerrja e detyrave nga Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	Ligji për Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	DMSH	NJPZSH, Subjektet të cilat janë bartëse të planit për GE	Gjatë vitit	Gjatë vitit	
3	Bashkëpunimi dhe koordinimi me ekspertë të fushave përkatëse në interes të emergjencave civile	Plani i punës	DMSH	Drejtoritë komunale, NJPZSH, OJQ, PK, Kryqin e Kuq	Gjatë vitit	Gjatë vitit	
